Përshkrimi i Specifikimeve Teknike të mallrave objekt i prokurimit, duhet të përshkruhen sa më saktë dhe plotësisht, për sa të jetë e mundur, duke krijuar kushte për konkurrencë të paanshme dhe të hapur midis të gjithë kandidatëve dhe ofertuesve. Specifikimet teknike, me përjashtim të rasteve plotësisht të justifikuara, duhet të hartohen në mënyrë të tillë që të marrin parasysh kriteret e aksesit për personat me aftësi të kufizuara ose projektimin për të gjithë përdoruesit, siç kërkohet nga ligji në fuqi.

SHËNIM: Në Specifikimet Teknike, nuk duhet të përshkruhet asnjë markë specifike prodhimi ose burim ose proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një Operator specifik Ekonomik ose ndonjë markë tregtare, patentë, tip ose origjinë ose prodhim specifik, për të favorizuar ose eliminuar ndërmarrje ose produkte të caktuara. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste të jashtëzakonshme kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë ose e kuptueshme për të përshkruar objektin e Kontratës. Referencat e tilla duhet të shoqërohen me fjalët "ose ekuivalent".

### SPECIFIKIME TEKNIKE

#### Objekti i shërbimit

*“Mirëmbajtje programit të faturimit dhe fiskalizim i faturave”,*

#### Afati i shërbimit

**12 muaj nga dita e lidhjes se kontrates**

#### Rezultatet që duhet të arrihen

*“Mirëmbajtje programit të faturimit dhe fiskalizim i faturave”,*

---

## 1. HYRJE

- Shoqëria ka në përdorim sistemin e Faturimit Flare Billing prej vitit 2021, të cilin e përdor në cloud dhe gjithashtu disponon kodin burim fillestar. Shoqëria ka nevojë që në këtë sistem, për përdoruesit e vet, të aktivizohen edhe disa module të tjera të nevojshme. Shoqëria nuk ka një infrastrukturë IT të mirefillte në ambientet e veta dhe për këtë arsye sistemin e kërkon dhe e përdor në Cloud. Gjithashtu përdoruesit

---

jane mesuar me kete menyre te punuari e cila sjell benefite per perdoruesit dhe shoqerine.

- Sistemi i faturimit eshte i integruar me sistemet e institucioneve financiare banke dhe jo banke nga te cilat shoqeria pret kalimin e pagesave qe abonentet bejne nepermjet po ketyre paleve te treta. Ne zbatim to Ligjit Nr. 2/2017, "Per Sigurine Kibernetike", si dhe Vendimit te Keshillit te Ministrave Nr. 553, date 15.07.2020, "Per miratimin e listes se infrastrukturave kritike te informacionit dhe te listes se infrastrukturave te rendesishme te informacionit", i ndryshuar, SHRUK-te ne Republiken e Shqiperise jane percaktuar, si operator i infrastrukturave kritike dhe te rendesishme te informacionit. Ne kete kontekst SHRUK-te duhet ne menyre periodike te marrin masa per upgrade dhe update te tyre, te kene nje plan te menaxhimit te riskut dhe te raportojne po ne menyre periodike ne AKCESK.
- Sistemi eshte shume i rendesishem per mbarevajtjen e aktivitetit normal te shoqerise dhe nderpreja e punes ne kete sistem sjell pamundesi per te arketuar e per pasoje ngerc ekonomik dhe paralizim te aktivitetit tregtar, moskorrektesi dhe mospermbushje detyrimesh kontraktore ndaj abonenteve, penalitete nga ana e organeve tatimore si dhe ulje te performances kundrejt objektivave te vendosur nga autoritete eprore si AKUKM, ERRU, Ministria e Infrastruktures dhe Energjise.
- **1.1. Qëllimi**
- Të behet upgrade i sistemit te faturimit Flare Billing dhe teknologjive perberese, te aktivizohet moduli i leximit bashke me aparate mobile PDA i integruar plotesisht me sistemin e faturimit, te aktivizohet moduli i fiskalizimit i integruar plotesisht me sistemin e faturimit, te rritet siguria e sistemit.
- **1.2. Objektivat**
- Të behet upgrade i sistemit te faturimit Flare Billing dhe teknologjive perberese, te vendoset moduli i leximit bashke me aparate mobile PDA i integruar plotesisht me sistemin e faturimit, te vendoset moduli i fiskalizimit i integruar plotesisht me sistemin e faturimit, te rritet siguria e sistemit, te vihet ne funksion sistemi i upgarduar dhe moduleve e pajisjeve sa me shpejt.
- **2.REZULTATET QË DUHET TË ARRIHEN**

---

Rezultatet konkrete që duhet të arrihen nga operatori ekonomik jane:

a. Upgrade i teknologjive perberese te Flare Billing:

- Upgrade i gjuhes se programimit;
- Upgrade i sistemit te bazes se te dhenave;
- Upgrade i server të raporteve;
- Upgrade i procedures se backup;

b. Upgrade i sistemit te faturimit Flare Billing,

c. Dorezimi i 5 pajisjeve PDA

c. Vendosja e modulit te leximeve te integruar me sistemin e faturimit dhe instalimi I App mobile ne 5 PDA e dorezuara

- 
- d. Vendosja e modulit te fiskalizimit te integruar me sistemin e faturimit
- e. Dorezimi i manualeve te perdorimit, dhe licensave te perditesuara te software aty ku nevojitet per nje afat te pakten deri ne perfundim te kontrates.
- f. Mirembajtje 1 vjeçare e sistemit ne cloud se bashku me modulet e reja dhe pajisjet PDA

### **3. SUPOZIMET DHE RISQET**

---

Faktori kyç i finalizimit me sukses të këtij projekti është njohja e mire e sektorit të ujesjelles kanalizimeve dhe specifikave që ka ky sektor dhe atyre që lidhen me shërbimet dhe produktet e kerkuara në këte procedure.

Bashkëpunimi i stafit të OE me stafin e shoqërisë sone do të lehtësojë përmbushjen me sukses të kontrates.

#### **Risqet**

- Mos njohja mire e specifikave të sektorit të ujesjellesave.
- Mos njohja mire e specifikave që lidhen me shërbimet dhe produktet e kerkuara
- Vonesa në procesin e analizës dhe reagimit në rast mosfunksionimi të sistemit.
- Mos përdorimi i paketave software të suportuara nga prodhuesi për upgrade të Flare Billing
- Mos marrja në konsideratë e veçorive që ka funksionimi i sistemeve të integruara dhe që funksionojnë në Cloud.
- Konfigurime “default” të pjesëve përberëse të sistemit të cilat mund të krijojnë vulnerabilitet për thyerjen e sigurisë.
- Konfigurime jo të sakta të rregullave të firewall dhe të monitorimit të “logs”.
- App mobile jo i përshtatshëm për të funksionuar në mënyrë optimale me PDA e ofruar.
- Mos realizimi i integritetit të moduleve sic ka kerkuar shoqëria jonë.
- Mos realizimi në kohë të kontrates e cila do të sillte kosto të konsiderueshme për shoqërinë tonë.

### **4. KËRKESAT FUNKSIONALE DHE TEKNIKE**

---

#### **Upgrade i funksionaliteteve**

Mënyra e operimit ekzistuese e periudhës së faturimit kërkon nderhyrje të specializuara teknike, jo nga nderfaqja e përdoruesit, gjë e cila nuk mund të kryhet nga vetë stafi i shoqërisë sone dhe sjell vonesa pasi kontrolli bëhet në mënyrë rastësore nga disa punonjës të shoqërisë sone në mënyrë manuale; *per konsumet mbi mestaren, konsumet negative, abonente pa mates, dublikime të zerave të artikujve, gabime në plane tarifore etj.*



---

Me me ane te Upgrad-it te funksionalitetit kerkohet te behet e mundur qe te gjitha keto procese te behen nga perdoruesit e sistemit nga nje nderfaqe pa qene nevoja per nderhyrjen e operatorit ekonomik.

Gjithashtu kerkohet te Upgradohet kontrolli pas mbylljes se periudhes te behet nga perdoruesi nepermjet funksioneve ne nderfaqen e programit.

Kerkohet te Upgradohet dhe menyra e sistemimeve per gabimet e gjetura gjate kontrolleve te mesiperme, ne keto momente behet manualisht nga perdoruesi. Me ane te Upgrade-it kerkohet te behet automatikisht nga vete sistemi.

Kerkohet te Upgradohet dhe menyra e fiskalizimit te faturave. Me ane te integritit te plote te modulit te fiskalizimit dhe Upgrad-imin e funksionalitetit ne nderfaqe te sistemit Flare Billing per procesin e fiskalizimit do te behet e mundur qe te shmangej perfshirja e operatorit ekonomik ne kete proces. Te gjitha keto Upgrade qe kerkohen te behen do ti kursenin shoqerise 7 dite pune qe do te thote shoqeria do te fillonte te arketonte 7 dite me heret se arketon ne keto momente gje e cila do te sillte situate me te mire financiare, planifikim me te mire buxhetor, dhe korrektesi ne pagesa me furnitore dhe detyrime te tjera.

- Upgrade menyra e mbylljes se periudhes se faturimit nga ajo nepermjet nderhyrjes se personave shume te specializuar tekniksht ne ate te funksionalitetit ne vetem me nderfaqe te sistemit nga punonjesit e shoqerise.
- Para mbylljes se periudhes se faturimit sistemi nepermjet funksionalitetit ne nderfaqe te realizoje kontrole te konsumeve si me poshte:
  - Konsume mbi mesataren per nje % te caktuar
  - Konsume negative
  - Konsume te pa rregjistruara (kur eshte abonent me mates dhe del pa konsum)
- Kontrole te integritetit te te dhenave si me poshte
  - Lidhja e planeve tarifore me kategorite e abonenteve
  - Regjistrim i nje artikulli per faturim me shume se nje here
- Per kontrollin e mesiperme, sistemi duhet te beje sistemimet automatikisht.
- Integrimin e plote dhe vendosjen e funksionalitetit fiskalizimit te faturave nga nderfaqe e sistemit per te bere te mundur fiskalizimin e faturave nga ana e perdoruesit.
- Instalimin e licences per versionin e implementuar

## **Upgrade i teknologjive**

Ne keto momente operohet me teknologjine PHP V.8. Per te pasur nje performance sa me te mire ne procesimin e programit kerkohet te kalohet ne PHP V.8.3. Me ane te ketij Upgradi do te kemi nje rritje ne performance, funksionalitete te reja dhe qendrueshmeri me te larte.

Gjithashtu kerkohet qe te Upgrad-ohet MySql nga V.8 ne V.8.03 gje cila bene te mundur te permiresime te storage engine te InnoDB, rritje e performances se serverit te mysql,

---

permiresime ne siguri (si validimi i passwordeve, permiresim i enkriptimeve). Me kryerjen e upgrade te bazes se te dhenave, mund te duhet te behen konfigurime te reja sipas parametrizimeve qe ofron versioni i ri i bazes se te dhenave. Ne te njejten menyre mund te duhet te modifikohen skemat e bazave te te dhenave ekzistuese qe versioni i bere upgrade te shfrytezohet ne menyre optimale per kapacitetet qe ofron. Gjithashtu ne versionin e bere upgrade duhet te konfigurohen te drejtat e perdoruesve dhe aspekte te tjera te sigurise ne menyre qe te ofrohet siguri maksimale per te mos lejuar nderhyrje te pa autorizuar ne sistem.

Te Upgrad-ohet Serveri reporteve Apache Tomcat per te bere te mundur rritje resursesh, shpejtesi me e larte shkrimi dhe leximi (I/O) e database, procesim me i shpejte request-esh.

Upgrade te menyres backup nga menyre manuale qe behet nga operatori ekonomik ne ate automatike ditore. Gjithashtu kerkojme qe te gjithë backupet ditore te ruhen ne nje storage jashte Clouidit ku eshte implementuar sistemi. Storage duhet te jete ne nje Cloud i certifikuar si “Trusted Cloud” ose ekuivalent dhe jo ne te njejtin lokacion ku eshte dhe serveri i sistemit per ti paraprire cdo lloj situatë qe mund te ndodhe ne Cloud-in e sistemit.

## **Integrimet dhe komunikimet**

Shoqeria ka kontrate me disa institucione financiare banke dhe jo banke per te pritur pagesat qe abonentet kryejne nepermjet tyre. Keto arketime jane shume te rendesishme per shoqerine tone. Keto pagesa regjistrohene ne Flare Billing automatikisht nepermjet integrimet qe sistemi ka me sistemet e ketyre institucioneve financiare. Ky komunikim kryhet nepermjet web sherbimeve informatike (web service) te cilat shkembejne informacion nepermjet protokolleve SOAP, REST ose ekuivalent sipas mundesive qe ofron secili institucion financiar ne vecanti.

Pagesat qe kryhen nepermjet institucioneve financiare paraqiten ne kohe reale ose pothuaj reale ne sistemin tone te faturimit, sipas mundesise qe ofron sistemi i pales se trete.

Perdoruesit e sistemit ne shoqerine tone kane mundesi aksesimi te ketyre te dhenave ne cdo moment si pe te pare arketimet ashtu edhe raportet perkatese lidhur me kete tematike.

Per te bere te mundur integrimin dhe komunikimin e sistemit te faturimit me sistemet e institucioneve financiare, ne i dergojme atyre tedhenat si me poshte:

- Url e Web sherbimit
- Kredencialet unike per secilin. Autentikimi funksionon me Token dhe OTP i cili gjenerohet duke perdorur nje algoritem dhe nje shared key. Keto dy te dhena jepen per t’u autentikuar filimisht ne program.
- Dokumentimi, per t’iu ofruar lehtesi institucioneve te pagesave ne realizimin e integrimet te sherbimit
- Te dhenat e pagesave te ardhura prej institucioneve te pagesave nuk ruhen ne asnje databaze tjeter te ndermjetme, pervec sistemit te faturimit.

- 
- Cdo komunikim me palet e treta eshte i gjurmueshem, ne menyre te tille qe te auditohen raste te pagesave ne raste te kerkuara te verifikimeve.
  - Nderfaqesimi i funksionaliteteve per pagesat nga palet e treta duhet te realizohet nepermjet protokolleve te njohura si psh SOAP, REST ose ekuivalent.

Nepermjet web sherbimeve (web service) ofrohet mundesia e kryerjes se veprimeve te meposhtme:

1. Pagesa te plota: Ne rastet ku paguhet e plote vlera e nje fature. Psh. paguhet vlera principal e fatures + kamatevonesa nqs per faturen perkatese eshte gjeneruar kamate, ne te kundert paguhet vetem vlera principal.
2. Pagesa e pjesshme te detyrimeve, pa permbushur vleren e plote te fatures qe abonenti ka kundrejt shoqerise. Psh. ne rastet kur eshte paguar principali i fatures dhe ka mbetur papaguar kamatevonesa, apo kur fatura mujore eshte ne vlere te madhe dhe abonenti e paguan me pjese.
3. Pagesa ne vlere me te madhe se vlera e detyrimit te abonentit
4. Pagesa te cilat kalojne si balance kreditore. Kjo ne rastet kur nje abonent mund te depozitoje vlere me te madhe parash se sa ka ne detyrim dhe diferenca kalon si balance kreditore. Ose ne rastet kur pagesen e kryer nuk e lidhin me faturat e palikujduara te abonentit dhe gjitha vlera e arketuar kalohet si balance.
5. Kerkimi i faturave me kodin e kontrates se abonentit.
6. Kerkimi i abonentit me numer fature.

### **Kerkesa per modulim e leximeve dhe app mobile per pajisjet PDA.**

1. Moduli duhet te kete nje nderfaqje administrimi. Ne kete nderfaqje perdoruesit duhet te menaxhojne te gjitha te dhenat te cilat akumulohen nga leximet ne terren, marin raporte operacionale dhe gjithashtu reporte te ndryshme per leximet dhe reporte te tjera te nevojshme per mireorganizimin e punes
2. Procesi i leximit duhet te garantoje procedura te qarta per Back Up periodik te te dhenave njesoj si sistemi i faturimit.
3. Leximet duhet te ruhen ne menyre te detajuar per ndryshimet qe behen mbi entitetet ne te njejten menyre si veprohet me hedhjen e leximit manual. Ne cdo moment administratoret e programit te kene mundesi te shikojne te dhena mbi vleren e vjeter, vleren e re, perdoruesin dhe oren e sakte kur eshte kryer veprimi.
4. Gjate hedhjes se leximeve per abonentet programi duhet te mundesoje shtimin e problematikave ne nivel te palimituar nenkategorish. Ky informacion duhet te sherbeje per te ndertuar reporte te detajuar per te percaktuar sakte problemet qe kane abonentet dhe veshtiresite qe kane lexuesit gjate punes se tyre.
5. Procesi i leximit duhet te mundesoje krijimin e ndarjes hierarkike zonale duke lejuar keshtu copezimin e zonave ne nen-zona me te menaxhueshme.

- 
6. Procesi i leximit duhet te ofroje mundesi per shtimin e nyjeve teknike ne menyre hierarkike. Tipologjia e nyjeve teknike duhet te jete dinamike per te mundesuar shtimin e metejshem. Per nyjet teknike duhet te ruhet edhe statusi ne te cilin ndodhet. Status i nyjes sherben psh: per te pare impaktin ne rast te riparimeve te ndryshme apo edhe per te gjeneruar njoftime automatike ne te ardhmen.
  7. Moduli duhet te mundesoje caktimin e zonave lexuesve. Programi duhet te njoftoje ne nje zone i eshte caktuar mepare nje lexuesi tjeter ne menyre te tille qe te behet perdorimi me eficence i burimeve njerezore.
  8. Moduli duhet te mundesoje percaktimin e itinerarit te leximeve per secilin lexues ne menyre kalendarike per cdo dite. Moduli duhet te siguroje shperndarjen e lexuesve ne menyre te tille qe mos kete perpasje ndermjet tyre, nuk mund ti caktohet 2 lexuesve te njejtet abonente.
  9. Procesi i sinkronizimit duhet te jete automatik dhe real time. Programi duhet te realizoje kalim e te dhenave te marra nga lexuesit ne menyre autmatike ne programin e faturimit.
  10. Nderveprimi midis aplikacionit per PDA dhe programit te instaluar ne cloud duhet te jete parashikuar e pavarur, e bazuar ne teknologjite e Web sherbimeve.
  11. Aplikacioni per PDA duhet te dergoje te dhena per vendodhje gjeografike te lexuesit ne momentin e marjes se leximit. Te dhenat gjeografike duhet te dergohen me nje precision sa me te larte.
  12. Marrja e pozicionit gjeografik duhet te jete i optimizuar ne perdorimin e baterise.
  13. Marrja e pozicionit gjeografik duhet te parashikojte situatat kur lexuesit gjenden ne zona pa mbulim nga satelitet si psh: brendesia e godinave etj. Ne kete rast aplikacioni mbeshtetes duhet te raportoje vendodhjen e fundit te sakte qe ka percaktuar nga sinjali GPS.
  14. Aplikacioni per PDA duhet te ofroje mundesine e sinkronizimit te mevonshem por gjithashtu duhet te sinkronizojte te dhenat ne kohe reale ne rastet kur gjendet ne zonat me mbulim te sinjalit celular ose wifi.
  15. Aplikacioni per PDA duhet te kerkoje berjen e fotografive ne cdo rast ose bazuar mbi logjiken e percaktuar nga administratori i programit ne panelin e administrimit te programit ne cloud.
  16. Aplikacioni per PDA duhet ti shfaqe lexuesit ne menyre te qarte itinerarin e planifikuar nga menaxheret e tyre nepermjet nderfaqes se administrimit.
  17. Aplikacioni per PDA duhet te perdore teknikat e kompresimit te informacionit per dergimin e te dhenave ne serverin qendror duke perdorur sa me pak banden e internetit.

- 
18. Aplikacioni per PDA duhet te perdore teknika te verifikimit te dergimit te sakte te dhenave ne server dhe duhet gjithashtu te perdore teknika te menaxhimit te deshtimit te lidhjes me server apo te nderprerjes se dergimit te te dhenave.
  19. Nderfaqja web e administrimit duhet te ofroje mundesi per inventarizimi e pajisjeve PDA duke lejuar regjistrimin e informacioneve shtese per cdo pajisje si psh: status i pajisjes, personi i cili e ka ne dorezim pajisjen, version i aplikacionit te instaluar ne PDA etj.
  20. Nderfaqja web e administrimit duhet te mundesoje shfaqjen e fotografive te ngarkuara ne program nga aplikacioni per PDA.
  21. Per cdo leximi te raportuar ne program ne nderfaqen e administrimit duhet te jepet mundesia e paraqitjes ne harte te pozicionit te lexuesit ne momentin e leximit.
  22. Nderfaqja web e administrimit duhet te ofroje reporte per nxjerrjen e variacionit te distances nga abonenti ne momentin e leximit te matesit.
  23. Nderfaqja web e administrimit duhet te mundesoje shfaqjen ne harte te itinerarit te nje lexuesi ne nje segment kohor te caktuar.
  24. Sinkronizimi i te dhenave duhet te perdore teknika te menaxhimit te situatave te konkurences per te evituar rastet e bllokimit te ndersjellte (deadlocks).
  25. Aplikacioni i PDA duhet te realizoje perditessimin e vetes nepermjet internetit pa perdorur sherbimet e Google Play ose ekuivalent.
  26. Aplikacioni i PDA duhet te ruaje log-e te aktivitetit te perdoruesit dhe duhet te mund ti dergoje keto ne server ne momentin e dergimit te kerkeses nga server.
  27. Aplikacioni i PDA duhet te implementoje mesazhet push te cilat mundesojne kryerjen e nje sere aktivitetesh ne PDA pa nevojten qe perdoruesi te kryeje ndonje veprim. Ky funksionalitet lehteson administrimin nga stafi qendror i IT te UK dhe shmang lexuesin nga njohja me funksionalitetet teknike.

### **Specifikimet teknike minimale te nevojshme per pajisjet PDA**

➤ Modeli pajisjes:	PDA
➤ Ekrani/	≥ 4inch
➤ Moduli i Kartave/	Nano SIM + SIM + Micro SD
➤ Komunikimi/	4G/3G
➤ Memorja/	2 GB Ram\32 GB Rom
➤ Camera/	≥13MP Mbrapa/ ≥5MP Para
➤ WiFi/	2.4Ghz/5Ghz/IEEE 802.11
➤ Bluetooth/	5.0

- 
- Niveli i Mbrojtjes/ IP68
  - Rezistente nga renia ne lartesi/ Jo me pak se 1.5 metra
  - Tipi Ekranit/ Touchscreen
  - Sensor Drite/ Po
  - Sensor Graviteti/ Po
  - Sensor Distance/ Po
  - Sensor Fushe Manjetike/ Po
  - Giroskopi/ Po
  - Tipi i Scanerit/ Scaner profesional per barkod
  - Largesia e Scanimit/ Min. 1 Meter
  - Tastjer Alfamerike Fizike/ Po
  - GPS/ AGPS/GPS/Galileo
  - NFC/ Po
  - Mikrofon/ Po
  - Porta e Karikimit/ Type C
  - Pesha/ <245gr
  - Bateria e zevendesueshme lehtesisht nga perdoruesi (Removable).
  - Bateria te jete te pakten 3,8V/5000mAh
  - Pajisja te jete rezistente nga uji deri ne 1.2 metra thellesi
  - Pajisja te punoje ne temperatura  $\leq -20^{\circ}\text{C}$  deri ne temperature  $\geq 55^{\circ}\text{C}$
  - Memoria (Storage) e pajisjes te punoje dhe te ruaje informacionin ne temperatura  $\leq -40^{\circ}\text{C}$  deri ne temperature  $\geq 70^{\circ}\text{C}$
  - Te kete karikuesin te perfshire dhe te jete origjinal nga prodhuesi
  - Garancia 1 vit.

### **Kerkesat per modulim e fiskalizimit**

#### **Abonenti:**

- Moduli te marre dhe te regjistroje automatikisht te gjithë klientet nga programi i faturimit.
- Moduli te kete opsionin e rregjistrimit te klientit manualisht.
- Moduli te rregjistroje kliente me ID te huaj.
- Moduli te rregjistroje automatikisht Emer Mbiemer, Adrese kur ne program vendoset Nipt-i i abonentit.
- Moduli te kete opsionin e kerkimit te nje klienti me ane te nr te kontrates, me ane te Nipti-t, ID te klientit ose me Emer Mbiemer.

- 
- Moduli te kete opsionin e exportimit te te gjithë klienteve ne format Excel.

### **Artikulli:**

- Moduli te marre dhe te regjistroje automatikisht te gjithë artikujt nga programi faturimit.
- Moduli te kete opsionin e rregjistrimeve manualisht te artikujve
- Moduli te kete opsionin e editimit te artikullit si ne pershkrim ashtu dhe ne cmim.
- Moduli te kete opsionin e vendosjes se artikujve me kod.
- Moduli te kete opsionin e kerkimit te nje artikulli me ane te kodit ose me pershkrim.
- Moduli te kete opsionin e exportimit te gjithë portin e te gjithë Artikujve ne format Exel.
- Moduli te kete opsionin e importimit me ane te file Exel.

### **Fatura:**

- Moduli te gjeneroje Faturen me para ne dore.
- Moduli te gjeneroje Faturen pa para ne dore (e thjeshte).
- Moduli te gjeneroje Faturen Elektronike.
- Moduli te gjeneroje Vetefaturimin.
- Moduli te gjeneroje Faturen Shoqeruese.
- Moduli te gjeneroje korigjimin e Fatures.
- Moduli te ruaje cdo version te Faturave.
- Moduli te mundesoje filtraper kerkim ne baze te emrit te klientit, dates, dhe totalit te fatures.
- Moduli te mundesoje exportin e te gjithë faturave ne file Excel.
- Moduli te ofroje opsionin e pranimit te faturave qe vijne nga furnitore te shoqerise.

### **Arka:**

- Moduli te mundesoje gjenerimin automatik te Mandatit te Arketimit per Faturat me para ne dore qe behen ne menyre manuale prane arkave te shoqerise.
- Moduli te mundesoje gjenerimin e Mandatit te Pageses.
- Moduli te mundesoje gjenerimin e raporteve per periudha te ndryshme per gjendjen e Arkes.

### **Konfigurimet:**

- Moduli duhet te kete nderfaqe per te gjithë konfigurimet e tij.
- Moduli te kete mundesi te krijimit te Roleve nga ana vet perdoruesit e SHRUK.

- 
- Moduli te mundesoje e konfrigurimin e te drejtave te detajuara dhe te kombinuara.

### **Funksione dhe vecori te tjera te Modulit:**

- Te fiskalizoje totalin e faturave brenda 24 oreve.
- Te integrohet me programin ekzistues te faturim-arketimit.
- Te gjeneroje automatikisht Librin e Shitjeve.
- Dergimin e sigurt te te dhenave ne sistemin tatimor, duke perdorur certifikaten elektronike.
- Transmetimin automatik te te dhenave ne administraten tatimore dhe marrjen e mesazhit konfirmues nga administrata tatimore, pas verifikimit automatik te seciles fature individuale ose fature shoqeruese.
- Ruajtjen e te dhenave te faturave ose te faturave shoqeruese.
- Gjenerimin e numrit te sigurise se leshuesit te fatures (NSLF) dhe numrit te sigurise se leshuesit te fatures shoqeruese (NSLFSH).
- Gjenerimin e kodit QR.
- Printimin e fatures ose thjesht kodit QR, ne situata te percaktuara ne ligjin “Per faturen dhe sistemin e monitorimit te qarkullimit”.
- Bazat e te dhenave, te jene te pa-aksesueshme jashte ketij sistemi.
- Hyrja ne program te sigurohet me kredenciale “Perdorues” dhe “Fjalekalim”.
- Te kete Log Files per cdo event gjate transmetimit te te dhenave nga programi drejt sistemit tatimor.
- Moduli duhet te ofroje mundesine e auditimit te veprimeve.

### **Kerkesat per Cloud**

- Kapaciteti  $\geq 1\text{TB}$
- Memory  $\geq 32\text{GB}$
- Te kete sistem operimi Linux version fundit ose ekuivalent.
- Te kete backup automatik ditor dhe kontroll te backup-it.
- Te jete i certifikuar si „Trusted Cloud“ ose ekuivalent

Operatori ekonomik duhet te implementoje te gjitha sistemin se bashku me modulet e reja ne Cloud. OE duhet te beje te gjitha konfigurimet e nevojshme qe sistemi te funksionje i integruar ashtu sic eshte kerkuar. Meqenese sistemi do te funksionoje ne Cloud dhe ai eshte i nje rendesie te vecante si per ne ashtu edhe per Repbuliken e Shqiperise, bazuar ne ligjin Nr. 25/2024, OE duhet te kryeje te gjitha instalimet dhe konfigurimet e nevojshme duke patur parasysh sigurine e te gjitha sistemit dhe te Cloud ku ai operon. Keto parime per tu



---

kujdesur per sigurine e sistemit OE duhet ti kete parasysh edhe gajte periudhes se mirembajtjes si per sistemin, ashtu edhe per vendodhjen e ruajtjes se backupeve te tij.

## 5. LOGJISTIKA DHE KOHA

---

### 5.1. Vendndodhja

Baza operative e projektit do të jetë në vendodhjet e rajoneve qe mbulon shoqeria jone. Sistemi do të funksionojë në cloud.

### 5.2. Data e Fillimit dhe Periudha e Implementimit të Detyrave

Data e fillimit të kontrates do të jetë data e nënshkrimit të kontratës dhe do te zgjase per 12 muaj.

Dorezimi i plote i konrates se bashku me upgrade, modulet dhe pajisjet do te jete 5 dite nga nenshkrimi i kontrates.

Kohezgjatja e licensave, mirembajtja ne cloud e sistemit te upgraduar, moduleve te reja dhe pajisjeve do te jete 12 muaj nga marrja ne dorezim.

## 7. PLANIFIKIMI I BUXHETIT PËR REALIZIMIN E PROJEKTIT

---

Ofertuesit duhet të paraqesin ofertën e tyre të detajuar sipas zërave dhe formatit në tabelën e mëposhtme:

Nr.	Emërtimi	Sasia	Çmimi me TVSH
1	Dorezimi i pajisjeve mobile PDA dhe venia ne pune e tyre	5 cope	
2	Upgrade i sistemit ekzistues Flare Billing	1	
3	Vendosja e modulit te leximit	1	
4	Vendosja e modulit te fiskalizimit	1	
5	Licensa perdorimi, mirembajtje ne cloud e sistemit te upgraduar me te gjithe funksionalitetet, integrimet, me modulet e reja, pajisjet PDA.	12 muaj	
<b>TOTALI ME TVSH (LEKË)</b>			-

## 9. MIREMBAJTJA

---

---

Meqenese sistemi do te funksionoj ne Cloud, nga operatori ekonomik kerkohen te kryhen ne distance keto aktivitete mirembajtje:

- Mirembajtje ne cloud e programit te faturimit, moduleve te leximit dhe fiskalizimit, pajisjeve PDA per nje periudhe 12 mujore.
- Funksionimi i programit te faturimit dhe moduleve te tij ne Cloud sipas SLA te dakordesuar mes paleve.
- Zgjidhje e problemeve prej keqfunksionimit te programit gjate kohezgjatjes se kontrates.
- Dorezim i raportit mujor te mirembajtjes ku te gjate monitorimit mujor te kihet parasysh edhe monitorimi ne aspektin e sigurise dhe jo vetem te mirefunksionimit te sistemit.
- Update qe OE i konsideron te nevojshme nga pikepamja e funksionimit dhe e sigurise.

Per tu siguruar ne kapacitetin e kryerjes dhe permbushjes se kontrates OE duhet te kete:

ISO 9001 (për Sistemin e Menaxhimit të Cilesisë)

ISO 27001 (për Sigurinë e Informacionit)

**-Operatori ekonomik duhet te jete i licensuar nga A.K.SH.I. dhe D.P.T. per ofrim zgjidhje software per fiskalizim.**

**-Operatori ekonomik duhet te kete te punesuar, per 3 (tre) muajt e fundit nga data e shpalljes se procedures, punonjes te diplomuar ne fushen e IT si inxhinieri informatike, informatike ekonomike, shkenca kompjuterike etj. qe kane certifikata si me poshte:**

1. Te pakten 3 punonjes te certifikuar ne implementim ose zhvillim te zgjidhjes se ofruar ku te pakten 1 eshte i certifikuar per sistemin e faturimit ekzistues Flare Billing ose ekuivalent, te pakten 1 eshte i certifikuar per moduln e leximeve te ofruar, te pakten 1 eshte i certifikuar per moduln e fiskalizimit te ofruar.
2. Te pakten 1 punonjes te certifikuar per zhvillimin ose administrimin e bazes se te dhenave qe perdor zgjidhja softwerike e ofruar
3. Te pakten 1 (nje) punonjes te certifikuar per sigurine ne Cloud
4. Te pakten 1 (nje) punonjes te certifikuar per menaxhimin e sherbimeve IT (ITIL) ose ekuivalente.
5. Te pakten 1 (nje) punonjes të certifikuar per SOACP (profesionist i certifikuar per arkitekture orientuar nga sherbimet) ose ekuivalent.
6. Te pakten 1 (nje) punonjes I certifikuar nga prodhuesi per konfigurim dhe mirembajtje te pajisjeve PDA te ofruar

---

**-Operatori Ekonomik duhet të paraqesë Autorizimin nga Prodhuesi/Distributori, ku të autorizohet operatori për shitjen e produkteve mobile PDA, software te upgraduar, moduleve te reja dhe ofrimin e sherbimeve të përfshira në këtë objekt prokurimi për territorin e Shqipërisë. Në rast të paraqitjes së autorizimit të Distributorit të verifikohet lidhja mes Prodhuesit dhe Distributorit. Dokumentacioni te jete ne gjuhen shqipe si dhe te kete te gjithe kontaktet (nr telefoni, E-mail) si dhe adresen web te prodhuesit apo Distributorit per konfirmim te dokumentave te paraqitura. Te jete e percaktuar emri, nipt dhe adresa fizike e operatorit ekonomik. Autorizimi te kete edhe daten e leshimit perpara dates se zhvillimit te tenderit.**

**-Operatori Ekonomik duhet të paraqesë nje certifikim i 3 viteve te fundit, leshuar per te nga prodhuesi pajisjeve mobile PDA te ofruara, qe App mobile i ofruar nga operatori ekonomik eshte i konfirmuar qe mirefunksionon me PDA e ofruar.**

**-Operatori Ekonomik duhet te jete i certifikuar nga ofruesi i sherbimit Cloud ku do te implementohet dhe do te funksionoje software gjate kohezgjatjes se kontrates ose te kete partneritet zyrtar me te. Te dorezohet nje dokument i leshuar nga ofruesi i sherbimit Cloud ose te jete i verifikueshem ne website zyrtar te ofruesit te sherbimit Cloud.**

**Nje punonjes mund te zoteroje me shume se 1 (nje) certifikate.**

**Argumentimi i specifikimeve teknike dhe termave te references:**

Specifikimet teknike jane hartuar nga struktura te specializuara/ Grup pune per objektin qe prokurohet, i ngritur me Urdher te Titullarit per hartimin e specifikimeve teknike/ termave te referencave, ne perputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, te LPP, si dhe nenit 41, pika 1, te VKM nr. 285, date 19.05.2021, “Per miratimin e rregullave te prokurimit publik”, **duke argumentuar çdo kerkese funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard te kerkuar**, ku çdo reference duhet te shoqerohet nga fjalet “ose ekuivalenti i tij/saj”.

**Objekti i sherbimit**

***“Mirëmbajtje programit të faturimit dhe fiskalizim i faturave”,***

**Afati i sherbimit**

**12 muaj nga dita e lidhjes se kontrates**

**Rezultatet qe duhet te arrihen**

***“Mirëmbajtje programit të faturimit dhe fiskalizim i faturave”,***

## Detyrat e Operatorit ekonomik

- Mirembajtje e programit te faturimit gjate gjithë periudhes se percaktuar ne kontrate
- Zgjidhje e problematikave teknike per keqfunsonim te software
- Dorezim i raportit mujor te mirembajtjes

## PERGJIGJA DHE SHKALLEZIMI I SHERBIMIT

Ne tabelen e meposhtme percaktohet kategorizimi seriozitetit te problemeve dhe koha e pergjigjes per zgjidhjen e tyre

Kategoria A ( Kritik/ I Larte)	Kategoria B (I Mesem)	Kategoria C (I Ulet)
Mos funksionimi i programit krijon apo rrezikon shumë aktivitetin normal	Mos funksionimi i programit krijon vonesa në aktivitetin normal	Mos funksionimi i programit pengon në mënyrë minimal aktivitetin
<b>Numri i përdoruesve të ndikuar</b>		
Mos funksionimi i programit ndikon një numër <i>shumë të madh</i> të përdoruesve	Mos funksionimi i programit ndikon një numër <i>të vogël</i> të përdoruesve	Mos funksionimi i programit ndikon pjesërisht në disa përdorues
<b>Pezullimi i punës</b>		
Mos funksionimi i programit pengon përdoruesit <u>të realizojnë pjesën më të madhe të punës së tyre.</u>	Mos funksionimi i programit pengon përdoruesit <u>të realizojnë pjesë te punës së tyre</u>	Mos funksionimi i programit pengon përdoruesit <u>të realizojnë disa pjesë të vogla të punës së tyre,</u>
<b>Zgjidhje alternative e përkohshme</b>		
<u>Nuk ka një mënyrë alternative</u> të përkohshme dhe të pranueshme për zgjidhjen e problemit	<u>Ka pjesërisht një mënyrë alternative</u> të përkohshme dhe të pranueshme për zgjidhjen e problemit.	<u>Ka një mënyrë alternative</u> të përkohshme dhe të pranueshme për zgjidhjen e problemit.
<b>Koha e përgjigjes</b>		
○ 30 min. për të kthyer përgjigje	○ 30 min.për të kthyer përgjigje	○ 30 min.për të kthyer përgjigje
<b>Koha e zgjidhjes</b>		
Maksimumi i pranimit të zgjidhjes është 24 orë pas	Maksimumi i pranimit të zgjidhjes është brenda 2	Maksimumi i pranimit të zgjidhjes është 10 ditë

kërkesës.	ditëve të punës.	kalendarike.
-----------	------------------	--------------

## Shtojca 6

(Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor)

(Kjo Shtojcë në rastin e Marrëveshjes Kuadër do të plotësohet nga autoriteti kontraktor vetëm gjatë rihapjes së procesit të mini-konkursit)

### FORMULARI I SHËRBIMEVE DHE GRAFIKUT TË EKZEKUTIMIT

Shërbimet që kërkohen që kërkohen: *“Mirëmbajtje programit të faturimit dhe fiskalizim i faturave”*,

Afatet e ekzekutimit: 12 muaj kalendarike nga dita e lidhjes se kontrates

<b>1</b>	<b>2</b>	<b>3</b>	<b>4</b>	<b>6</b>
<b>Shërbimi</b>	<b>Përshkrimi i shërbimi</b>	<b>Sasia</b>	<b>çmimi për njësi</b>	<b>Çmimi total për shërbim(3 x 4X)</b>
<b>1.</b>	<i>“Mirëmbajtje programit të faturimit dhe fiskalizim i faturave” per 12 muaj</i>			

Shërbimet	Përshkrimi	Shuma	Vendi i ekzekutimit	Afati i ekzekutimit
1	<i>“Mirëmbajtje programit të faturimit dhe fiskalizim i faturave”</i> per 12 muaj		Sipas specifikimeve teknike	12 muaj kalendarike nga dita e lidhjes se kontrates(sipas specifikimeve teknike)

Nr.	Emërtimi	Sasia	Çmimi me TVSH
1	Dorezimi i pajisjeve mobile PDA dhe venia ne pune e tyre	<b>5 cope</b>	
2	Upgrade i sistemit ekzistues Flare Billing	<b>1</b>	
3	Vendosja e modulit te leximit	<b>1</b>	
4	Vendosja e modulit te fiskalizimit	<b>1</b>	
5	Licensa perdorimi, mirembajtje ne cloud e sistemit te upgraduar me te gjithë funksionalitetet, integrimet, me modulet e reja, pajisjet PDA.	<b>12 muaj</b>	
<b>TOTALI ME TVSH (LEKË)</b>			<b>-</b>

## Shtojca 7

( Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor)

### TERMAT E REFERENCES

Objekti dhe qëllimi i shërbimeve:

Ky shërbim kryhet për të bërë *Mirëmbajtje programit të faturimit dhe fiskalizim i faturave*” për 12 muaj si dhe për të bërë të mundur funksionimin normal të punës në Shoqërinë SHRUKGJ.

Kryerja e shërbimit objekt prokurimi, është në funksion të veprimtarisë së Shoqërisë Rajonale Ujesjelles Kanalizime Gjirokaster Sh.a

---

Shpërndarja:

Sherbimet qe do te kryhen do te behen sipas nevojave te Autoritetit Kontraktues SHRUKGJ

Vendi dhe dorëzimi i shërbimeve:

Shoqeria Rajonale Ujesjelles Kanalizime Gjirokaster Sh.a

## **Shtojca 8**

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor]

### **FORMULAR I I KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT**

#### **1. KRITERET E PËRGJITHSHME TË PËRZGJEDHJES/ KUALIFIKIMIT**

Ofertuesi deklaron se:

- a) është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;
  - b) nuk është në proces falimentimi (status aktiv);
  - c) nuk është dënuar për ndonjë vepër penale, në përputhje me nenin 76/1 të LPP-së;
  - ç) personi (personat) që veprojnë si anëtar i organit administrativ, drejtori ose mbikëqyrësi, aksioneri ose ortak, ose që ka fuqi përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda Operatorit Ekonomik, nuk është i dënuar ose nuk ka qenë i dënuar nga një vendim i gjykatës i formës së prerë për çdo vepër penale, të përcaktuar në nenin 76/1 të LPP-së;
  - d) nuk është dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë në lidhje me veprimtarinë profesionale;
- dh nuk ka pagesa pashlyera të taksave dhe kontributeve të sigurimeve shoqërore, ose ndodhet në një prej kushteve të parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së;
- e) ka paguar energjinë elektrike dhe plotëson kërkesat që burojnë nga legjislacioni në fuqi. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.
  - f) nuk është në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;

---

g) ushtron veprimtarinë në përputhje me legjislacionin përkatës mjedisor, social dhe të punës;

gj) ka paraqitur një Ofertë të pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;

h) kryen aktivitetin në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi.

i) nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë/kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të përfituar fonde publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi.

Nëse gjuha e përdorur në procedurë është gjuha shqipe, atëherë dokumentet e gjuhës së huaj duhet të shoqërohen nga një përkthim i noterizuar në shqip.

Këto kritere duhet të përmbushen me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës, sipas Shtojcës 9.

Në rast bashkimi të operatorëve ekonomikë, secili anëtar i grupit duhet të paraqesë Vetëdeklarimin e lartpërmendur.

Në rast se operatori ekonomik ofertues do të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, Vetëdeklarimi i lartpërmendur duhet të paraqitet edhe nga subjekti mbështetës.

### **Kriteret e Përgjithshme të Pranimit nuk duhet të ndryshohen nga Autoritetet Kontraktore.**

Në çdo rast, Autoriteti Kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme për vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga Operatori Ekonomik, për sa më sipër.

Nëse oferta paraqitet nga një bashkim Operatorësh Ekonomikë, do të paraqitet :

- Marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet Operatorëve Ekonomikë, ku caktohet përfaqësuesi, përqindja e pjesëmarrjes në bashkim, dhe elementët që merr përsipër të realizojë secili prej anëtarëve të bashkimit.
- Nëse, një operator ekonomik dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, ai i vërteton autoritetit kontraktor se do të ketë në dispozicion burimet e nevojshme, duke dorëzuar një angazhim me shkrim të këtyre subjekteve për këtë qëllim.



---

## **2. KRITERET E VEÇANTA TE KUALIIMIT**

### **1. Ofertuesi duhet të paraqesë:**

a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8

b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;

***Argumentimi:** Kriteret e mesiperme janë vendosur në përputhje me nenin 82 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit” dhe neni 83 “Sigurimi i ofertes”, të ligjit nr.162/2020, “Per Prokurimin Publik” si dhe në mbështetje të nenit 30, pika 1, të VKM-se nr.285, datë 19.5.2021, “Per Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik: citojmë neni 83 i LPP “Autoriteti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertes nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlera të vogël”, neni 82, i LPP “1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoritetet ose entet kontraktore pranojnë si prova paraprake në vend të disa vertetimeve të leshuara nga autoritetet publike ose pale të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas parashikimeve të këtij ligji. Përmbajtja e këtij formulari përcaktohet në rregullat e prokurimit publik”.*

### **2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:**

-Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare (2020,2021,2022), ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e madhe se 20% e fondit limit.

**Argumentimi:** Kërkesa e mesiperme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe nenin 77, pika 3, të LPP, si dhe nenin 43, pika 2/b, neni 55 pika 4 germa b), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Per miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë: “Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohej operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalohet:

---

.... 20 % te vleres se parashikuar te kontrates, ne procedurat e prokurimit nen kufirin e ulet monetar”. Kjo procedure eshte nen kufirin e ulet monetar dhe per kete arsye, vlera e xhiros minimale te kerkuar, eshte brenda kufirit te parashikuar ne dispozitat ligjore te sipercituara....

*Si dhe neni 55/4.....” Ne kete lloj procedure prokurimi, autoritetet kontraktore duhet te mbajne ne konsiderate te percaktojne kriteret te thjeshtuara pranimi, me qellim nxitjen e pjesemarrjes se biznesit te vogel dhe te mesem.*

*Kerkesat ekonomike financiare duhet te kerkohen ne raport me objektin e prokurimit, duke marre ne konsiderate qe plotesimi i ketyre kerkesave mund te behet vetem me paraqitjen e xhiros vjetore te realizuar nga operatoret ekonomike. Vlera e xhiros se kerkuar ne kete lloj procedure prokurimi nuk mund te tejkalohet 20% te vleres se perlllogaritur te kontrates, sipas parashikimeve ne nenin 43, te ketyre rregullave.”*

Percaktimi i viteve te kerkuara per paraqitjen e vertetimit te xhiros vjetore eshte bere bazuar ne nenin 43, pika 2/b, te VKM nr. 285, date 19.05.2021 “Per miratimin e rregullave te prokurimit publik”, si dhe ne legjislacionin e fushes ne fuqi, perkatesisht ne Ligjin nr. 8438, date 28.12.1998 "Per tatimin mbi te ardhurat", i ndryshuar, VKM nr. 922 date 29.12.2014 "Per deklarimin e detyrueshem te deklarave tatimore dhe te dokumenteve te tjera tatimore, vetem nepermjet formes elektronike", si dhe ne Udhezimin e Ministrit te Financave nr.5, date 30.01.2006, "Per tatimin mbi te ardhurat", i ndryshuar. Ne çdo rast, kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare do të konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor.

## **2.3 Kapaciteti teknik**

**2.3.1 Furnizime të mëparshme të ngjashme me një vlerë jo më të ulët 20% të fondit limit të objektit të prokurimit, të realizuar gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontrates, vertetuar me dokumentacionin vertetues si më poshtë:**

- për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vertetime të leshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontrates, ku të shenohen vlera, afati i përfundimit të kontrates ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shenohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.
- për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruarat në organet tatimore, ku shenohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

**Argumentimi:** Kërkesa e mesipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, date 23.12.2020 “Per prokurimin publik” dhe nenin 41, pika 3 dhe neni 55 pika 4 germa b), të VKM nr. 285, date 19.05.2021 “Per miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” .....Për kontratat e mallrave dhe shërbimeve vlera totale e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të vogël se 20% të vlerës së përlllogaritur të kontrates, që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tri viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontrates.

---

*Me ane te ketij kriteri kerkohej qe operatoret ekonomike te deshmojne qe kane pervojen e nevojshme per te zbatuar kontraten, prandaj eshte kerkuar qe sherbimet e meparshme te ngjashme te jene ne vleren jo me pak se 20 % te vleres se fondit limit, qe eshte brenda vleres kufi te percaktuar ne nenin e sipercituar.*

Percaktimi i vleres se kerkuar per kontratat e ngjashme eshte vendosur brenda kufirit te vleres te percaktuar ne rregullat e prokurimit publik dhe i sherben AK per te treguar se ofertuesit me kapacitetet e tyre kane realizuar kontrata te ngjashme me objektin qe prokurohet, ne vlere jo me te vogel se 20 % te fondit limit, ne afat, me cilesi dhe rrit besueshmerine mbi pervojen qe ka ofertuesi ne treg. Pervoja e ngjashme konsiderohet si kriter thelbesor dhe si rrjedhim operatoret ekonomike duhet te paraqesin deshmi te tilla si referenca/fatura tatimore, per te provuar kryerjen e tyre qofte me sektorin privat dhe ate publik.

### **2.3.2 Operatori ekonomik duhet të jetë i pajisur dhe të paraqesë certifikatat e lëshuara nga organizmat e vlerësimit të konformitetit, të akredituara nga organizmi kombëtar i akreditimit DPA, ose organizma ndërkombëtare akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, të jenë të vlefshme, e që kanë lidhje me objektin e kontratës, si më poshtë:**

- a) ISO 9001 (ose ekuivalente) (për Sistemin e Menaxhimit të Cilesisë)
- b) ISO 27001 (ose ekuivalente) (për Sigurinë e Informacionit)

Argumentim: Kërkesa më sipër është vendosur në mbështetje të nenit 36, pika 3, e ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, ku citohet:

“3.Specifikimet teknike duhet të përshkruajnë qartë kërkesat e autoritetit ose entit kontraktor, duke iu referuar:

a) kërkesave funksionale ose të performancës, përfshirë karakteristikat mjedisore, me kusht që parametrat të jenë të saktë në mënyrë që t’u japin mundësi ofertuesve të përcaktojnë objektin e kontratës dhe autoriteteve ose enteve kontraktore të japin kontratën;

b) standardeve kombëtare, që mbështeten në ato ndërkombëtare, miratimeve teknike ndërkombëtare, specifikimeve teknike të përgjithshme, standardeve ndërkombëtare apo sistemeve të tjera teknike të referimit, të përcaktuara nga organet ndërkombëtare të standardizimit. Kur këto nuk ekzistojnë, ato u referohen standardeve kombëtare, miratimeve teknike kombëtare ose specifikimeve teknike kombëtare, që lidhen me projektimin, përlogaritjen dhe ekzekutimin e punëve ose përdorimin e produkteve;

c) kërkesave në terma funksionalë sipas shkronjës “a”, referuar specifikimeve teknike sipas shkronjës “b” të kësaj pike, si mënyrë që nënkupton pajtueshmëri me kërkesat funksionale; 23 ç) të dyja metodave të përcaktuara në shkronjat “a” dhe “b” të pikës 3 të këtij neni, për mallra, shërbime ose punë të ndryshme, të përfshira në të njëjtin objekt kontrate. Çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.

Nëpërmjet kësaj kërkesë Autoriteti Kontraktor kërkon garantimin e një shërbimi të vijueshëm dhe cilësor për realizimin me sukses të kontratës.

Kërkesat e mësipërme janë përcaktuar në mbështetje të nenit 77, pika 4 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”,

...“Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore

---

e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie...”

si dhe në mbështetje të nenit 44, pika 1 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” (i ndryshuar) konkretisht:

... “Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit...”

**a) ISO 9001 (ose ekuivalente), për sistemin e menaxhimit të cilësisë:**

ISO 9001 (ose ekuivalente) parashikon një tërësi rregullash që garantojnë një bazë rreziku parandalues ndaj cilësisë e cila mbulon një gamë të gjerë të çështjeve ku përfshihen: angazhimi i lartë i menaxhimit për cilësi nga operatori ekonomik, përshtatshmërinë e burimeve të tij, kompetencën/profesionalizmin e punonjësve, procesin e menaxhimit (për furnizim, ofrimin të shërbimeve dhe proceset mbështetëse e administrative), planifikimin e cilësisë, garantimin e një procesi cilësor të furnizimit, sigurimin e konformitetit për shërbimet, proceset e tij për të zgjidhur ankesat e klientëve, veprime korigjuese, dhe një kërkesë për të nxitur përmirësimin. Kjo kërkesë, dëshmon se mbajtësi i saj garanton standardet ndërkombëtare të menaxhimit të cilësisë së ushtrimit të aktivitetit tregtar të tij.

Kërkesa për ISO 9001 ose ekuivalente, është një kërkesë e domosdoshme për të garantuar realizimin me sukses të kontratës.

**b) ISO 27001 (ose ekuivalente), për sistemin e menaxhimit të sigurisë së informacionit:**

ISO 27001 është një kuadër standartizues në lidhje me garancitë që kërkon autoriteti kontraktor nga operatorët ekonomikë në lidhje me :

- mirëmbajtjen e sistemit ISMS (Information Security Management System) brenda vetë organizatës së operatorit ekonomik.
- aplikimin e praktikave të sigurisë për menaxhimin e risqeve të sigurisë.
- aplikimin e praktikave të sigurisë për trajtimin e të dhënave sensitive.
- aplikimin e masave dhe praktikave të sigurisë për shërbimet e kryera në ambiente sensitive.

Referuar sa më sipër cituar, ky standard i kërkuar, lidhet ngushtësisht dhe drejtpërdrejtë me zërat e kërkuara objekt kontrate.

**2.3.3 Operatori ekonomik duhet të ketë të punësuar, për 3 (tre) muajt e fundit nga data e shpalljes së procedurës, punonjës të diplomuar në fushën e IT si inxhinieri informatike, informatike ekonomike, shkencë kompjuterike etj. që kanë certifikata si më poshte:**

*Argumentimi:* Kjo kërkesë vendoset në mbështetje të nenit 77 pika 1 e Ligjit Nr. 162 date 23.12.2020 “Per prokurimin publik”, ku parashikohet se:

Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:

- 
- a) pershtatshmerine per te kryer veprimtarine profesionale;
  - b) gjendjen ekonomike dhe financiare;
  - c) aftesine teknike dhe profesionale.

Per realizimin e ketij sherbimi kerkohet qe ne secilen nga fushat kryesore te projektit, operatori ekonomik te perdori punonjes teknik ne numer te mjaftueshem dhe te kualifikuar. Fushat e mesiperme te ekspertizes dhe certifikimit te punonjesve, jane kryer ne baze te komponenteve te projektit si dhe te mases se angazhimit te specialisteve. Diplomimi i punonjesve eshte kerkuar ne perputhje me objektin e prokurimit dhe termat e references pasi ky objekt prokurimi perfshin implementimin, adaptimin, testimin, migrim dhe instalimin e te gjitha informacioneve teknike te sistemit. Ne e kemi shume te nevojshme realizimin ne kohe te shkurter te kontrates. Ne jemi te bindur qe nese OE qe ploteson kapacitet e kerkuara te pergjithshme e te vecanta dhe ve ne dispozicion punonjes me diplomimin dhe certifikimet sic do te vijoje ne vazhdim ateher mund te arrije te gjitha kerkesat e kerkuara prej nesh.

- a. **Te pakten 3 punonjes te certifikuar ne implementim ose zhvillim te zgjidhjes se ofruar ku te pakten 1 eshte i certifikuar per sistemin e faturimit ekzistues Flare Billing ose ekuivalent, te pakten 1 eshte i certifikuar per moduln e leximeve te ofruar, te pakten 1 eshte i certifikuar per moduln e fiskalizimit te ofruar.**

**Argumentim:** Kriteri garanton AK per aftesite profesionale te punonjesve qe ka OE. Sistemi i faturimit eshte jetik per ushtrimin e aktivitetit tregtar te shoqerise. Meqenese eshte i tille, ne kerkojme qe te gjitha implementimet e upgrade, integrimet, venia ne pune te kryhen ne nje afat jo me shume se 1 muaj. Per te realizuar kete, nese OE ka ne dispozicion punonjes te certifikuar per kete sistem qe ne perdorim ose ekuivalent me te, do te garantonte AK qe OE ka mundesi ti permbushe me se miri kerkesat qe lidhen me ate sistem. Perverc upgrade eshte kerkuar dhe implementimi i moduleve te leximit se bashku me app mobile per PDA dhe te fiskalizimit te integruar plotesisht me sistemin ekzistues. Qe te zbatohet projekti brenda afateve te keruara ne gjykojme qe shume procese pune duhet te kryhen ne paralel dhe ne sinkron nga OE ne funksionet qe lidhen me upgrade te sistemit ekzistues te faturimit, moduln e leximit dhe ate te fiskalizimit si edhe venien ne pune te pajisjeve PDA per operatoret e leximit te shoqerise.

Per kete arsye dhe per te arritur rezultatin e pritshem nga AK, kerkohet qe OE te kete ne dispozicion 3 punonjes te cilet te punojne ne paralel te certifikuar secili per te pakten nje prej aspekteve te produkteve e sherbimeve qe kerkohen. Nese OE nuk ka ne dispozicion te pakten kete numer punonjesish me keto certifikata, rrezikohet qe ky sistem i rendesishem per AK te mos perfundoje ne kohe ose te mos i behet upgrade i pershtatshem i cdo komponenti te kerkuar, vendosja e moduleve te reja ne pune, integrimi i plote i tyre dhe venia ne pune e PDA me sistemi ne ofruar.

Disponimi i 1 (nje) punonjes te certifikuar per zgjidhjen e faturimit ekzistuese ose ekuivalent garanton implementimin e te gjitha specifikimeve te kerkuara nga AK lidhur me upgrade dhe permiresimet. Gjithashtu keta punonjes garantojne vijueshmerine normale te punes per gjate gjithe periudhes se kontrates. Programues te certifikuar per zgjidhjen e faturimit jane te domosdoshem sepse ata dine se si lidhen te gjithe komponentet me njera tjetren, njohin arkitekturen e sistemit, dine si te zhvillojne te gjithe sherbimet e kerkuara duke ruajtur dhe permiresuar cilesite e sistemit.

1 (nje) punonjes i certifikuar per moduln e leximeve qe do te ofrohet kerkohet pasi ai ka komponente shume te rendeishme server side dhe app mobile qe do te perdoret nga lexuesit, nepermjet PDA, ne terren, per te mbledhur te dhenat e matesve. App mobile duhet te jete i implementuar ne menyre te pershtatshme per te komunikuar ne menyre te

---

vazhdueshme me sistemin ne server, te jete i sakte, te mos humbase te dhenat e lexuara deri ne ate moment te cilat mund te mos jene sinkronizuar, te ruaje logs perdorimi per arsye investigimi, te perdore baterine e PDA ne menyre eficente. Aplikacoini ne server duhet te jete i implentuar ne menyren e pershtatshme gjithashtu per te mundesuar funksionim optimal gjate gjithë kohes duke perfshire edhe periudhat e ngarkeses edhe sikur te gjithë lexuesit te jene duke sinkronizuar App mobile ne te njejten kohe. Moduli i leximeve ne teresi duhet te jete i integruar plotesisht ne sistemin ekzistues te faturimit per te kryer te gjitha kerkesat e percaktuara ne Specifikimet Teknike. Ky modul duhet te jete instaluar dhe konfiguruar ne menyre te tille qe ti pergjigjet kerkesave te perdoruesve gjate gjithë periudhes se kontrates, duke perfshire edhe momentet kur te gjithë perdoruesit jaen duke punuar ne te njejten kohe si per te marre raporte ashtu edhe per te pare rezultatet e sinkronizimeve qe vijne prej App mobile te lexuesve.

1 (nje) punonjes i certifikuar per modulim e fiskalizimit te ofruar duhet per te garantuar implementim te pershtatshem duke perfshire te gjithë konfigurimet dhe integrimet e kerkuara. Rasti i shoqerise sone eshte i tille qe moduli i fiskalizimit pervec se duhet te ofroje te gjithë vecorite teknike te kerkuara, duhet edhe te jete konfiguruar ne menyre te tille qe te perballoje ngarkese te konsiderushem per fiskalizimin e faturave sidomos gjate periudhes se gjenerimit te faturave mujore kur brenda 1 ore duhet te fiskalizohen me dhjetra mijera fatura. Edhe gjate momenteve te ngarkesave te tilla ky modul duhet ti pergjigjet perdoruesve ne arka apo ne zyra te shoqerise qe duan te veprojne me sistemin per cfaredo lloj veprimi qe ofron moduli. Qe ky sistem te funksionje me se miri duhet qe edhe integrimet te kryhen ne menyre te pershtatshme te cilat jane aftesi dhe njohuri teknike qe mudn ti kete vetem nje punonjes i certifikuar per ate zgjidhje pasi ky punonjes duhet te marre parasysh aspekte teknike sic jane komunikimet me ane te web sherbimeve me sistemin e faturimit per disa lloj veprimesh, komunikimi me sistemi ne tatimeve per disa lloj veprimesh, perdorimi optimal i burimeve te cloud ku eshte instaluar dhe bazes se te dhenave ku operon, adresimi i sigurise lidhur me aksesin qe kane perdoruesit dhe te drejtat qe kane ne sistem, etj.

**b. Te pakten 1 punonjes te certifikuar per zhvillimin ose administrimin e bazes se te dhenave qe perdor zgjidhja softwerike e ofruar**

**Argumentim:** Baza e te dhenave eshte shume e rendesishme per cdo sistem informatik, sidomos per sisteme te cilat funksionojne ne Cloud, kane nje numer te konsiderueshem perdoruesish, perpunojne dhe ruajne sasi te medha te dhenash, per sisteme te rendesie te vecante sic konsdrohen SHRUK prej AKCESK bazuar ne ligjin Nr. 25/2024, duhet te perballojne ngarkese te larta si ne shkrim dhe ne lexim kur ne te njejten kohe duhet edhe te ruajne te dhenat por edhe ti pergjigjen perdoruesve qe gjenerojne raporte me sasi te konsiderueshme te dhenash ne te njejten kohe, te jene te sigurta dhe te mos lejojne aksesim te pa autorizuar sidomos kur sistemt ndodhen ne Cloud. Per te realizaur te gjithë keto kerkohet te pakten 1 punonjes me certifikimin si me siper.

**c. Te pakten 1 (nje) punonjes të certifikuar per SOACP (profesionist i certifikuar per arkitekture orientuar nga sherbimet) ose ekuivalent.**

**Argumentim:** AK i eshte referuar nje certifikate te mirenjohur SOACP, Servide Oriented Architecture Certified Professional, si nje certifikate qe garanton per njohurite dhe aftesite ne sisteme me arkitekture te orientuar nga sherbimet, qe OE ta kete si referim per te kuptuar ekspertizen teknike te kerkuar per ta plotesuar ate ose nepermejt kesaj certifiakte ose nepermjet nje certifikate ekuivalent me te. Ky kriter vjen si nevojë per te garantuar ruajtjen funksionale dhe upgrade optimal te integrimëve dhe komunikimeve mes sistemit te faturimit me sistemet e tjera sic jane sistemet informatike te institucioneve financiare,

---

modulit te leximeve, modulit te fiskalizimit, te cilat kryhet nepermjet web sherbimeve. Te gjithë keto komunikime do te jete e nevojshme te pershtaten me komponentet e bera upgrade. Mirefunksionimi i ketyre sherbimeve dhe ruajtja efektive dhe eficente e arkitektures se orientuar nga sherbimet qe sistemi ka, eshte thelbesore per mirefunksionimin e sistemit. Mos funksionimi i disa prej sherbimeve sjell si pasoje mosrealizim te qellimit te ketij sistemi ku permendim aktivitet thelbesore per ushtrimin e funksioneve tona si shoqeri tregtare sic jane pamundesi per te arketuar faturat nepermjet institucioneve financiare, pamundesi per te kryer leximin e matesve te ujit nepermjet modulit te leximeve, pamundesi per te fiskalizuar faturat ne menyre integruar. Keto sherbime duhet te jene njekohesit edhe te sigurt per te garantuar saktesine dhe privatesine e te dhenave qe shkembhen. Per te gjithë arsyt e mesiperme AK ka vendosur kriterin e mesiperme.

**d. Te pakten 1 (nje) punonjes te certifikuar per sigurine ne Cloud**

**Argumentim:** Kriteri per disponimin e te pakten 1 (nje) punonjes te certifikuar per sigurine ne Cloud vjen si nevoje pasi zgjidhja kerkohet te funksionojë gjate gjithë kohes ne cloud dhe per kete arsye AK duhet te jete i sigurt qe OE ka te punesuar punonjes qe garantojne implementimin e sigurt te zgjidhjes dhe cdo sherbimi te kerkuar ne cloud gjate gjithë kohezgjatjes se kontrates. Gjithashtu ne zbatim te Ligjit Nr. 2/2017, "Per Sigurine Kibernetike", si dhe Vendimit te Keshillit te Ministrave Nr. 553, date 15.07.2020, "Per miratimin e listes se infrastrukturave kritike te informacionit dhe te listes se infrastrukturave te rendesishme te informacionit", i ndryshuar, Ligji Nr. 25/2024, SHRUK jane percaktuar, si operator i infrastrukturave kritike dhe e rendesishme e informacionit si rrjedhim sistemi dhe infrastruktura mbeshtetese e ofruar duhet te zbatojne parimet me te mira te sigurise dhe per kete arsye nder punonjesit qe OE do te angazhoje per zbatimin e kesaj kontrate duhet patjeter nje punonjes qe mbulon fushen e sigurise ne Cloud.

**e. Te pakten 1 (nje) punonjes te certifikuar per menaxhimin e sherbimeve IT (ITIL) ose ekuivalente**

**Argumentim:** Kjo kerkese lidhet me rezultatet qe duhet te permbushen nga Operatori Ekonomik, sipas kerkesave te shprehura ne DST ku percaktohen kohet e nderhyrjeve dhe termat e tjera te nivelit te sherbimit SLA (sherbimet e mirembajtjes). Nje certifikim ITIL eshte nje set praktikash dhe kuadri rregullash dhe idesh per realizimin e sherbimit ne teknologjine e informacionit dhe komunikimit, qe eshte pjese e qellimit te projektit te autoritetit kontraktor. Kjo kerkese i deshmon autoritetit kontraktor qe operatori ekonomik (nepermjet stafit te certifikuar si me siper, garanton ideimin, konceptimin e sherbimeve IT te projektit, menaxhimin e tyre, duke zbatuar SLA, sipas standardeve nderkombetare te njohura, ne gjithë ciklin e tyre, perfshire ketu dhe sherbimet e mirembajtjes qe jane shume te rendesishme per AK dhe te vena ne dukje ne DST dhe specifikime teknike.

**Kriteri konsiderohet i permbushur me plotesimin e formularit te vetedeklarimit sipas shtojces 9. Perpara publikimit te njoftimit paraprak te fituesit dhe nisjes se afateve te ankimit OE i kualifikuar ne vend te pare per te vertetura disponimin e punonjesve te mesiperme duhet te paraqese dokumentacionin si meposhte:**

- **Formulareve E-SIG per periudhen e 3 muajve te fundit duke iu referuar dates se shpalljes se procedures**
- **Certifikatat/transcriptet qe vertetojne certifikimet e mesiperme te kerkuara**
- **Diplomat e shkolles se larte**

Nje punonjes mund te disponoje me shume se nje certifikim.

---

*Argumentimi: Ne baze te pikes 4, te nenit te 77, te ligjit nr. 162, date 23.12.2020 "Per prokurimin publik" dhe nenit 41, pika 4/ b), te VKM nr.285, date 19.05.2021 "Per miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik", me ane te ketij kriteri kerkohet qe operatoret ekonomike te deshmojne qe kane stafin, personelin e nevojshem te kualifikuar per realizimin me sukses te kontrates.*

**2.3.4 Operatori Ekonomik duhet të paraqesë Autorizimin nga Prodhuesi/distributori, ku të autorizohet operatori për shitjen e produkteve software dhe ofrimin e shërbimeve të përfshira në këtë objekt prokurimi për territorin e Shqipërisë. Në rast të paraqitjes së autorizimit të Distributorit të verifikohet lidhja mes Prodhuesit dhe Distributorit. Dokumentacioni të jete ne gjuhen shqipe si dhe te kete te gjithë kontaktet (nr telefoni, E-mail) si dhe adresen web te prodhuesit apo Distributorit per konfirmim te dokumentave te paraqitura. Te jete e percaktuar emri, nipt dhe adresa fizike e operatorit ekonomik. Autorizimi te kete edhe daten e leshimit perpara dates se zhvillimit te tenderit.**

*Argumentimi: Autorizimi i prodhuesit është një dokument i rëndësishëm, pasi përveçse tregon origjinën e mallrave/shërbimeve që kërkohen në procedurë, na garanton se ofertuesi është i autorizuar për ofrimin tek AK të këtyre mallrave/shërbimeve sipas kërkesave ne specififikimet teknike.*

*Sipas specififikimeve teknike, kerkohet nder te tjera upgrade i sistemit ekzistues i cili eshte nje produkt i gatshem. Upgrade nenkupton instalimin e versionit me te fundit te ketij sistemi i cili ofrohet nga prodhuesi i tij. Per shkak te rendesise dhe kriticitetit qe sistemi ka per shoqerine*

*, si ne aspektin funksional ashtu edhe te sigurise, OE qe interesohen per te zbatuar kete kontrate duhet qe te kryejne upgrade duke dorezuar dhe instaluar paketat origjinale te software te marra nga prodhuesi.*

*Per te garantuar me sukses permbushjen e te gjithë kërkesave teknike gjate gjithë kohezgjatjes se kontrates, per te garantuar zgjidhjen e problemeve te paparashikuara qe mund te hase OE gjate kryerjse se proceeve te punes deri ne dorezim te plote te kontrates, nevojitet të kenë mbështetje nga prodhuesi i zgjidhjes për rastet e perballjes me situata te paparashikuara si dhe për zgjidhjen e problematikave të mundshme gjatë fazes se mirembajtjes.*

*Ky kriter është jo diskriminues, është në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës dhe lidhet drejtpërdrejtë me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë e OE ofertues për aftësitë teknike. Kjo kërkesë i shërben autoritetit kontraktor për njohjen e mundësisë së OE-se për përmbushjen me sukses të kontratës. Ky kriter është në përputhje me nenin 77, pika 4, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik" dhe pikën 6, të nenit 40, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik".*

*Per produktet software ose komponentet qe ofrohen falas nga prodhuesi te cilat vetem shperndahen por nuk shiten, nuk eshte i nevojshem autorizimi por mjafton qe OE te permende emrin e komponentit, burimin ku do ta marre psh website zyrtar, dhe nje burim ne internet ose dokument te vertetueshem nga AK ku percaktohet qe prodhuesi ose distributori i saj e ofron falas dhe lejon sherpndarjen per kedo.*



---

**2.3.5 Operatori Ekonomik duhet të paraqesë një certifikim i 3 viteve të fundit, leshuar nga një prodhues pajisjesh mobile PDA për operatorin ekonomik, që App mobile i ofruar nga operatori ekonomik është i konfirmuar që mirefunksionon me PDA e atij prodhuesi.**

*Argumentimi:* Çdo muaj janë të pakten 1200 lexues të shpërndarë në të gjithë territorin e Shqipërisë që lexojnë matelat e energjisë elektrike dhe plotësojnë të dhënat në App mobile në PDA. Mëqenëse lexuesit e zhvillojnë aktivitetin e tyre në terren, në vendodhje të tilla që mund të mos kenë mbulim interneti, që e kanë të pamundur të karikojnë PDA, por që njëkohësisht duhet të arrijnë objektivin e leximeve ditore dhe mujor, të cilat nuk janë kushte normale sic mund të jenë ato kur përdor telefonin inteligjent një person në jetën e tij personale. Për këtë arsye duhet që App mobile të jetë i tillë që shfrytëzon në mënyrë optimale të gjithë burimet dhe kapacitetet e PDA dhe i vjen në ndihmë lexuesit në mënyrën më të mirë të mundshme për të përmbushur detyrat e tij. Nepermjet këtij kriteri AK kërkon garanci që App mobile i cili do të bëjë upgrade App mobile ekzistues është i pershtatshëm për PDA.

**2.3.6 Operatori Ekonomik duhet të jetë i certifikuar nga ofruesi i shërbimit Cloud ku do të implementohet dhe do të funksionojë software gjatë kohezgjatjes së kontratës ose të ketë partneritet zyrtar me të. Të dorëzohet një dokument i leshuar nga ofruesi i shërbimit Cloud ose të jetë i verifikueshëm në website zyrtar të ofruesit të shërbimit Cloud.**

*Argumentimi:* Kërkesa e mesipërme vjen se rrjedhojë në zbatim të Ligjit Nr. 2/2017, "Për Sigurimin Kibernetik", si dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 553, datë 15.07.2020, "Për miratimin e listës së infrastrukturave kritike të informacionit dhe të listës së infrastrukturave të rëndësishme të informacionit", i ndryshuar, ligjit Nr. 25/2024. Cdo SHRUK është përcaktuar, si operator i infrastrukturave kritike dhe të rëndësishme të informacionit. Për këtë arsye, në mungesë të një infrastrukture nga ana e shoqërisë kërkohet që operatori ekonomik të garantojë me anë të një dokumenti që është i certifikuar ose partner zyrtar i Cloud-it ku operon dhe mirëmbahet sistemi dhe back-up-et e tij për të garantuar AK për kapacitetin e provuar të OE lidhur me shfrytëzimin e Cloud-it. Për në është garanci e shtuar që OE ka certifikim ose partneritet me ofruesin e shërbimit Cloud pasi kjo tregon vlerësimin dhe konfirmimin për kapacitetet që OE zoteron për të arritur atë status.

**2.3.7 Operatori ekonomik duhet të jetë i licensuar nga A.K.SH.I. dhe D.P.T. për ofrim zgjidhje software për fiskalizim.**

*Argumentimi:* Sipas ligjit për fiskalizimin e faturave Nr 87/2019 "Për faturën dhe monitorimin e sistemit të qarkullimit" kërkohet që operatori ekonomik të jetë i licensuar për zgjidhjen që do të ofroje për fiskalizimin e faturave të shoqërisë që kërkohet në këtë procedurë.

---

**b**

**Shtojca 9.**

**FORMULARI PËRMBLEDHËS I VETËDEKLARIMIT**

Unë i nënshkruari \_\_\_\_\_ në cilësinë e \_\_\_\_\_ të operatorit ekonomik \_\_\_\_\_ deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë që:

**A. Pjesa I: Informacion në lidhje me Operatorin Ekonomik**

<b>Identifikimi</b>	<b>Përgjigja</b>
Emri i operatorit ekonomik: (Ju lutemi renditni të gjithë operatorët ekonomikë nëse jeni një BOE. Ju lutemi tregoni rolin e operatorit ekonomik në BOE	-----
Numri NIPT/et:	-----
Adresa postare: Qyteti / qyteti; Kodi postar	-----
Përfaqësuesi (emri):	-----
Telefoni:	-----
E-mail:	-----

## B: DEKLARATË

Për nënkontraktorët dhe subjektet në kapacitetet, e të cilave do të mbështetet Operatori Ekonomik (nëse është e zbatueshme)

Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë se:

- **Informacione për nënkontraktorin**

Emri i nënkontraktorit të propozuar	NIPT -i	Përqindja e nënkontraktimit	Mallrat/ shërbimet e lidhura me to për t'u nënkontraktuar

- **Informacion mbi subjektet mbi kapacitetin, e të cilëve do të mbështetet operatori ekonomik**

Emri (at) e subjekteve	NIPT-i	Lloji i kapacitetit për të cilin do të mbështetet operatori ekonomik	Specifiko konkretisht kapacitetin/et

## Pjesa II: Shkaqet e përjashtimit

### A: DEKLARATA PËR PËRMBUSHJEN E KRITEREVE TË PËRGJITHSHME TË KUALIFIKIMIT

#### Deklarata

Operatori ekonomik është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv.

<i>Sqarimenëse</i>	<i>vlerësohet</i>	<i>e</i>	<i>nevojshme</i>	
<hr/>				
<p>Operatori ekonomik nuk është dënuar për ndonjë nga veprat penale të parashikuara në nenin 76/1 të LPP-së ose ka qenë i dënuar dhe ka kaluar një periudhë 5-vjeçare nga data e ekzekutimit të dënimit, nëse nuk është përcaktuar një periudhë tjetër nga gjykata, sipas parashikimeve të nenit 76 të LPP-së.</p>				
<i>Sqarime</i>	<i>nëse</i>	<i>vlerësohet</i>	<i>e</i>	<i>nevojshme</i>
<hr/>				
<p>Personi / personat në cilësinë e anëtarit të organit administrativ, drejtorit ose mbikëqyrësit, si aksionar ose si ortak, ka ose kompetenca përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik, si më poshtë:</p>				
<hr/>				
<p>etj.</p> <p>nuk janë të dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për ndonjë nga veprat penale të përcaktuara në nenin 76/1 të LPP-së ose kanë qenë të dënuar dhe ka kaluar një periudhë 5-vjeçare nga data e ekzekutimit të dënimit, nëse nuk është përcaktuar një periudhë tjetër nga gjykata, sipas parashikimeve të nenit 76 të LPP-së, etj.</p>				
<i>Sqarime</i>	<i>nëse</i>	<i>vlerësohet</i>	<i>e</i>	<i>nevojshme</i>
<hr/>				
<p>Operatori ekonomik nuk është dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për vepra që lidhen me veprimtarinë profesionale.</p>				
<i>Sqarime</i>	<i>nëse</i>	<i>vlerësohet</i>	<i>e</i>	<i>nevojshme</i>
<hr/>				
<p>Operatori ekonomik nuk është në proces falimentimi (statusi aktiv).</p>				
<i>Sqarime</i>	<i>nëse</i>	<i>vlerësohet</i>	<i>e</i>	<i>nevojshme</i>
<hr/>				
<p>Operatori Ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet për taksat dhe kontributet e sigurimeve shoqërore, sipas legjislacionit në fuqi, ose ndodhet në një nga rastet e parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së.</p>				
<i>Sqarime</i>	<i>nëse</i>	<i>vlerësohet</i>	<i>e</i>	<i>nevojshme</i>
<hr/>				
<p>Operatori ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet e energjisë elektrike, për të gjitha adresat e ushtrimit të aktivitetit, sipas legjislacionit përkatës në fuqi.</p> <p>Ky informacion kërkohet për operatorët ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.</p>				
<i>Sqarime</i>	<i>nëse</i>	<i>vlerësohet</i>	<i>e</i>	<i>nevojshme</i>

Operatori ekonomik ushtron aktivitetin e tij në zbatimin e kërkesave ligjore në fuqi.				
<i>Sqarime</i>	<i>nëse</i>	<i>vlerësohet</i>	<i>e</i>	<i>nevojshme</i>
Operatori ekonomik nuk është në listën e operatorëve ekonomikë të ndaluar për të fituar kontrata publike në përputhje me nenin 78 të LPP-së.				
Operatori ekonomik nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë /kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të përfituar fonde publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi.				
<i>Sqarime</i>	<i>nëse</i>	<i>vlerësohet</i>	<i>e</i>	<i>nevojshme</i>

## **B: DEKLARATA “Për Dorëzimin e Ofertave të Pavarura”**

Ne cilësinë e përfaqësuesit të operatorit ekonomik, në mbështetje të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, si dhe në mbështetje të Ligjit Nr.9121/2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, bëj këtë deklaram dhe garantoj se deklaratat e mëposhtme janë të vërteta dhe të plota në çdo aspekt:

1. Unë kam lexuar dhe kuptuar përmbajtjen e kësaj Deklarate;
2. Unë kuptoj që oferta e paraqitur do të s’kualifikohet dhe/ose përjashtohet nga fitimi i kontratave publike, nëse kjo Deklaratë vërtetohet se nuk është e plotë dhe / ose e saktë në çdo aspekt;
3. Unë jam i autorizuar nga Ofertuesi të firmos këtë Deklaratë dhe të paraqes ofertë në interes të Ofertuesit;
4. Çdo person, firma e të cilit shfaqet në dokumentacionin e ofertës, është i autorizuar nga Ofertuesi për të përgatitur dhe për të nënshkruar ofertën në interes të Ofertuesit;
5. Për qëllim të kësaj deklarate dhe ofertës së paraqitur, unë kuptoj që fjala “konkurrentë” nënkupton çdo operator tjetër ekonomik, të ndryshëm nga Ofertuesi, të paraqitur ose jo si bashkim operatorësh ekonomik, që:
  - a) paraqesin një ofertë në përgjigje të Njoftimit të Kontratës dhe/ose të Ftesës për Ofertë, të bërë nga Autoriteti Kontraktor;
  - b) është një ofertues i mundshëm, i cili bazuar në kualifikimin, aftësitë ose përvojat e tij, mundet të dorëzojë një ofertë në përgjigje, të Njoftimit të Kontratës dhe/ose të Ftesës për Ofertë.

6. Ofertuesi deklaron se: (kliko një nga alternativat e mëposhtme):

a) Ofertuesi ka përgatitur ofertën e tij në mënyrë të pavarur, pa u konsultuar, pa komunikuar dhe pa bërë marrëveshje apo pa rënë dakord me asnjë konkurrent tjetër;

b) Ofertuesi është konsultuar, ka komunikuar, ka bërë marrëveshje me një ose më shumë konkurrentë në lidhje me këtë procedurë prokurimi. Ofertuesi deklaron se në dokumentet bashkangjitur, në detajet e kësaj oferte, janë përfshirë emrat e konkurrentëve, natyra dhe shkaqet e konsultimit, komunikimit, marrëveshjes apo angazhimit (rasti i bashkimit të operatorëve ekonomikë ose nënkontraktimit).

7. Në veçanti, pa kufizuar paragrafët 6. a) dhe 6. b), të përmendur më lart, nuk ka pasur konsultime, komunikime, kontratë apo marrëveshje me ndonjë konkurrent në lidhje me:

a) çmimet ;

b) metodat, faktorët ose formulat e përdorura për llogaritjen e çmimit;

c) qëllimin apo vendimin për të paraqitur apo jo një ofertë; ose,

d) paraqitjen e një oferte që nuk i plotëson specifikimet e kërkesës për ofertë.

8. Përveç kësaj, nuk ka pasur konsultime, komunikime, marrëveshje apo kontrata me ndonjë konkurrent në lidhje me cilësinë, sasinë, specifikimet apo dërgesa të veçanta të produkteve apo shërbimeve të cilat lidhen me prokurimin në fjalë, përveç se kur janë deklaruar sipas paragrafit të mësipërm 6. b).

9. Kushtet e ofertës nuk u janë bërë të njohura dhe as nuk do t'u bëhen të njohura me qëllim nga Ofertuesi konkurrentëve të tjerë, në çdo mënyrë qoftë, para datës dhe kohës së hapjes zyrtare të ofertave, shpalljes fitues dhe lidhjes së kontratës, vetëm nëse kërkohet me ligj ose nëse deklarohen në mënyrë specifike sipas paragrafit 6.b).

### C: DEKLARATA “Mbi Konfliktin e Interesit”

#### Deklarata

Në cilësinë e operatorit ekonomik, ne deklarojmë se jemi të vetëdijshëm për sa vijon:

Konflikti i interesit është një situatë e konfliktit midis detyrës publike dhe interesit privat të një zyrtari, në të cilën ai / ajo ka interesa private direkte ose indirekte që ndikojnë, ose që mund të ndikojë ose që duket se ndikojnë në kryerjen e padrejtë të detyrave dhe detyrimeve publike.

Në përputhje me nenin 21, paragrafi 1, Ligji Nr. 9367, datë 07.04.2005, kategoritë e zyrtarëve siç parashikohen në Kapitullin III, Seksioni II, që janë absolutisht të ndaluara të përfitojnë drejtpërdrejt ose indirekt nga nënshkrimi i kontratave midis një pale dhe institucionit publik janë:

- Presidenti i Republikës, Kryeministri, Zëvendës Kryeministri, Ministrat, ose Zëvendësministrat, Deputetët, Gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese, Gjyqtarët e Gjykatës së Lartë, Kreu i Kontrollit të Lartë të Shtetit, Prokurori i Përgjithshëm, Gjyqtarët dhe Prokurorët në nivelin e Gjykatës së Shkallës së Parë dhe Gjykatës së Apelit, Avokati i

Popullit, Anëtarët e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, Anëtarët e Këshillit të Lartë të Drejtësisë, Inspektori i Përgjithshëm i Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesit, Anëtarët e Enteve Rregullatore (Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë, përfshirë Guvernatorin dhe Zëvendësguvernatorin; konkurrenca; telekomunikacioni; energjia elektrike; furnizimi me ujë; sigurimi; bonot; autoritetet e medias), sekretarët e përgjithshëm të institucioneve qendrore si dhe çdo zyrtar publik në çdo institucion publik pozicioni i të cilit është i barabartë me atë të Drejtorit të Përgjithshëm, drejtuesit e organeve të administratës publike që nuk janë pjesë e shërbimit civil.

- Për nëpunësit civilë të nivelit të mesëm, sipas nenit 31 dhe zyrtarët sipas nenit 32 të kreut III, seksionit 2 të këtij ligji, ndalimi në paragrafin 1 të këtij neni, për shkak të interesave private të zyrtarit, siç përcaktohet këtu të zbatohet vetëm në rast të lidhjes së kontratave brenda fushës dhe territorit të institucionit dhe juridiksionit të institucionit, ku punon zyrtari. Ky ndalim do të zbatohet edhe kur pala në kontratë është një institucion varësie.

Kur zyrtari është kryetar bashkie ose nënkryetar i një bashkie ose komune, ose kryetar i një këshilli rajonal, anëtar i këshillit përkatës, ose një zyrtar i lartë i menaxhimit të një njësie të qeverisjes vendore, ndalimi për shkak të interesave private të zyrtarit, specifikuar këtu, do të zbatohet vetëm në rastin e lidhjes së kontratave, nëse ka, me bashkinë, komunën ose rajonin ku zyrtari ushtron një detyrë të tillë. Ky ndalim do të zbatohet gjithashtu kur pala në kontratë është një institucion publik në varësi të kësaj njësie (neni 21, paragrafi 2, Ligji Nr. 9367, datë 07.04.2005).

Ndalimet e parashikuara në nenin 21, paragrafët 1, 2 të Ligjit Nr. 9367, datë 07.04.2005, me përjashtimet përkatëse, do të zbatohen në të njëjtën masë edhe për personat e lidhur me zyrtarin, d.m.th. **bashkëshortin, bashkëjetuesin, fëmijët madhorë e prindërit e zyrtarit dhe të bashkëshortit dhe bashkëjetuesit.**

Unë jam në dijeni të kërkesave dhe ndalimeve të parashikuara në Ligjin Nr. 9367, datë 07.04.2005 "Për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funkcioneve Publike", të ndryshuar, dhe aktet nënligjore të miratuara në bazë të tij nga Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive, si dhe Ligji Nr. 162/2020, datë 23.12.2020 "Për Prokurimin Publik".

Në përputhje me to, unë deklaroj këtu se asnjë zyrtar publik, siç përcaktohet në Kapitullin III, Seksioni II të Ligjit Nr. 9367, datë 07.04.2005, dhe në këtë deklaratë, nuk ka ndonjë interes privat, direkt ose indirekt, me personin juridik që unë përfaqësoj këtu.

#### **D: DEKLARATA “Për zbatimin e dispozitave ligjore në marrëdhëniet e punës”**

##### **Deklarata**

Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë se:

- Operatori ekonomik \_\_\_\_\_garanton mbrojtjen e të drejtës së punësimit dhe profesionit nga çdo formë diskriminimi, të parashikuar nga legjislacioni i punës në fuqi.
- Operatori ekonomik\_\_\_\_\_lidh me punëmarrësit kontratat përkatëse të punës dhe garanton masat në drejtim të sigurisë dhe shëndetit në punë për të Gjithë dhe, në mënyrë të veçantë, për grupet e rrezikuara, bazuar në legjislacionin e punës në fuqi.
- Operatori ekonomik \_\_\_\_\_nuk ka masë Ligjore në fuqi, të vendosur nga Inspektoriati Shtetëror i Punës dhe Shërbimeve Shoqërore (ISHPSHSH). Në rastet kur janë konstatuar shkelje ligjore, operatori ekonomik ka marrë masat e nevojshme për adresimin e tyre, brenda afateve të përcaktuara nga ISHPSHSH.

*Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme*

### **Pjesa III Kriteret e Përzgjedhjes/Kualifikimit**

#### **A: DEKLARATË “Në përputhje me specifikimet teknike dhe grafikun e realizimit të objektit të kontratës”**

<b>Deklarata</b>	<b>Përgjigje</b>
Në cilësinë e operatorit ekonomik, ne deklarojmë se plotësojnë të gjitha specifikimet teknike, siç udhëzohet në dokumentet e tenderit, dhe këtë e provojmë përmes certifikatave dhe dokumenteve të paraqitura me këtë deklaratë (nëse kërkohet nga Autoriteti Kontraktor), dhe marrim përsipër të realizojmë objektin në përputhje me Listën e mallrave dhe grafikun e lëvrimit të përcaktuar nga Autoriteti kontraktor.	Po [ ] Jo [ ]

#### **B: DEKLARATË**

##### **Për disponimin e punonjësve dhe makinerive të nevojshme (nëse kërkohen)**

<b>Deklarata</b>	<b>Përgjigje</b>
Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë se:  Unë kam punonjësit e nevojshëm si dhe mjetet dhe makineritë për ekzekutimin e kontratës, siç përcaktohet në dokumentet e tenderit,	<u>Punonjës</u>  Po [ ] Jo [ ]  Nëse, po, numri i punonjësve:  _____



<p>dhe e vërtetoj këtë me dokumentacionin përkatës, të cilin do ta paraqes në kopje origjinale ose të noterizuar nëse fitoj, ose nëse më kërkohen sqarime nga autoriteti kontraktor.</p>	<p>Profili i punonjësve</p> <hr/> <p><u>Makineri e mjete</u></p> <p>Po [ ] Jo [ ]</p> <p>Nëse po, të listohen me të dhënat konkrete:</p> <hr/>
<p><b>Emri, Mbiemri</b> _____</p> <p><b>Firma</b> _____</p> <p><b>Vula</b> _____</p> <p><b>Data e dorëzimit të deklaratës</b> _____</p>	

**Ju lutemi sigurohuni që:**

- Secili pjesëmarrës i renditur në një bashkim operatorësh ekonomikë të paraqesë një Formular të veçantë të Vetëdeklarimit.
- Në rast se, operatori ekonomik ofertues do të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, një Formular i veçantë i Vetëdeklarimit duhet të paraqitet edhe nga subjekti mbështetës.
- Çdo vetdeklarim i pavërtetë/pasaktë nga ana e operatorëve ekonomikë jo vetëm që përbën shkak për skualifikimin nga procedura konkrete, por përbën shkak dhe për përjashtimin e tyre nga e drejta për të fituar kontrata publike deri në 3 vjet, sipas parashikimeve të ligjit për prokurimin publik.
- Operatorët ekonomikë që ofertojnë në procedurat e prokurimit të vetdeklarojnë në çdo rast informacionin e saktë që i korrespondon gjendjes së tyre faktike.

Në çdo rast, autoriteti kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme për vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik për sa më sipër.

- *Në çdo rast, përpara publikimit të njoftimit të fituesit paraprak dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti kontraktor duhet t'i kërkojë ofertuesit fitues që të dorëzojë dokumentet provuese për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, si dhe dokumentet e paraqitura si pjesë e ofertës në rrugë*

---

*elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin.*

- *Informacioni i pasqyruar në formularin e vetëdeklarimit, i cili gjendet në një bazë të dhënash, ku autoriteti kontraktor mund të aksesojë direkt këtë informacion dhe /ose dokumentin, duhet të shoqërohet me adresën përkatëse për këtë bazë të dhënash.*

Shtojca 10

### **Formulari i Njoftimit të Skualifikimit<sup>2</sup>**

[Vendndodhja dhe data]

[Emri dhe adresa e Autoritetit/ Kontraktor]

[Adresa e Ofertuesit]

I nderuar, Z. / Znj. <Emri i kontaktit >

Ju falënderojmë për pjesëmarrjen tuaj në procedurën e sipërpërmendur të prokurimit publik. Procedura u zhvillua në përputhje me Ligjin Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”.

Oferta juaj u vlerësua me kujdes në bazë të kushteve dhe kërkesave të përcaktuara në Njoftimin e Kontratës dhe dosjen e ofertës. Me keqardhje ju informojmë se jeni skualifikuar pasi oferta e paraqitur nga ju është refuzuar për arsyen (et) e mëposhtme:

---

---

---

---

Nëse mendoni se autoriteti kontraktor ka shkelur LPP-në ose RPP-në gjatë procedurës së prokurimit publik, ju keni të drejtë të inicioni një procedurë rishikimi pas publikimit të njoftimit të fituesit sipas parashikimeve të Kapitullin XIV të Ligjit të Prokurimit Publik.

---

<sup>2</sup>Ky njoftim do të përdoret në rastin e procedurave të prokurimit të zhvilluara në rrugë shkresore

---

Megjithëse nuk mund t'i përdorim shërbimet tuaja në këtë rast, ne besojmë se do të mbeteni të interesuar për iniciativat tona të prokurimit.

Me respekt,

**Titullari i Autoritetit Kontraktor**

## Shtojca 11

### FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT (PARAPRAK)

[Data]

Drejtuar: [Emri dhe adresa e Ofertuesit fitues]

Procedura e prokurimit/lotit:

Numri i procedurës / referenca e Lotit: Përshkrimi i shkurtër i kontratës: [Objekti, sasi dhe kohëzgjatja e kontratës]

Publikimet e mëparshme (nëse është rasti): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në kosto

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim

Me anë të këtij Njoftimi ju informojmë se, në këtë procedurë kanë marrë pjesë Ofertuesit e mëposhtëm me këto vlera përkatëse të ofruara:

1. \_\_\_\_\_

\_\_\_\_\_

*Emri i plotë i shoqërisë*

*Numri i NIPT-t*

Vlera

\_\_\_\_\_

\_\_\_\_\_

(e shprehur në shifra dhe fjalë)

---

2. \_\_\_\_\_

---

*Emri i plotë i shoqërisë*

*Numri i NIPT-it*

Vlera

---

*(e shprehur në shifra dhe fjalë)*

Etj. \_\_\_\_\_

Nga pjesëmarrësit janë skualifikuar Ofertuesit e mëposhtëm:

1. \_\_\_\_\_

---

*Emri i plotë i shoqërisë*  
*arsyet e mëposhtme*

*Numri i NIPT-it*

2. \_\_\_\_\_

---

*Emri i plotë i shoqërisë*  
*arsyet e mëposhtme*

*Numri i NIPT-it*

\* \* \*

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë [*emri dhe adresa e ofertuesit fitues*], se oferta e paraqitur me vlerë totale prej \_\_\_\_\_ [*shuma përkatëse e shprehur me fjalë dhe shifra*] / totali i pikëve të marra [\_\_\_\_\_] është identifikuar si fitues (paraprak) i procedurës së prokurimit.

Me publikimin e këtij njoftimi, fillojnë afatet e ankimit sipas përcaktimeve në nenin 110 të Ligjit Nr. 162/2020, datë 23.12.2020, “Për Prokurimin Publik”.

---

## Shtojca 12

[Shtojcë për tu plotësuar nga Autoriteti Kontraktor]

### **FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT <sup>3</sup>**

***(NË PËRFUNDIM TË AFATEVE TË ANKIMIT)***

[Data]

Drejtuar: [Emri dhe adresa e Ofertuesit fitues]

Procedura e prokurimit/lotit

Numri i procedurës / referenca e Lotit: Përshkrimi i shkurtër i kontratës: [Objekti, Sasi dhe kohëzgjatja e kontratës] Publikimet e mëparshme (nëse është rasti): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në kosto

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim

Me anë të kësaj ju informojmë se Ofertuesit e mëposhtëm kanë marrë pjesë në këtë procedurë me këto vlera përkatëse të ofruara:

---

<sup>3</sup> Ky Formular është i aplikueshëm nëse ka Ankime

---

1. \_\_\_\_\_

---

*Emri i plotë i shoqërisë*

*Numri i NIPT-t*

Vlera

---

*(e shprehur në shifra dhe fjalë)*

2. \_\_\_\_\_

---

*Emri i plotë i shoqërisë*

*Numri i NIPT-it*

Vlera

---

*(e shprehur në shifra dhe fjalë)*

Etj. \_\_\_\_\_

Janë skualifikuar Ofertuesit e mëposhtëm:

1. \_\_\_\_\_

\_\_\_\_\_

---

*Emri i plotë i shoqërisë*

*Numri i NIPT-it*

*arsyet*

2. \_\_\_\_\_

\_\_\_\_\_

---

*Emri i plotë i shoqërisë*

*Numri i NIPT-it*

*arsyet*

\* \* \*

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë [emri dhe adresa e ofertuesit të shpallur fitues] se oferta e paraqitur, me një vlerë të përgjithshme prej [shuma përkatëse e shprehur në fjalë dhe shifra]/pikët totale të marra [\_\_\_\_\_] është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë [emri dhe adresa e autoritetit kontraktor dhe referenca e kontaktit] sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda \_\_\_\_\_ ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose nuk dorëzon sigurimin e kontratës brenda afatit përfundimtar tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do të konfiskohet sigurimi i ofertës suaj dhe kontrata do t'i akordohet ofertuesit vijues në klasifikimin përfundimtar, oferta e të

---

cilit është dorëzuar me një vlerë të përgjithshme prej [vlera përkatëse e shprehur në fjalë dhe shifra], siç parashikohet në nenin 83 të Ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”.

Ankesa pas Njoftimit të Fituesit (Paraparak)

PO  JO

Nëse Po (vendimi përfundimtar për trajtimin e ankesës/ave nr. datë) \_\_\_\_\_

Ankesa pas Njoftimit të Anullimit të procedurës:

PO  JO

Nëse Po (vendimi përfundimtar për trajtimin e ankesës/ave nr. datë) \_\_\_\_\_

**[TITULLARI I AUTORITETIT KONTRAKTOR]**

### **Shtojca 13**

[Shtojcë për tu plotësuar nga Autoriteti Kontraktor në rastin e Marrëveshjes Kuadër]

## **FORMULARI I NJOFTIMIT TË OPERATORËVE EKONOMIKË TË SUKSESSHËM NË MARRËVESHJEN KUADËR (PARAPRAK)**

[Data]

---

Drejtuar: [Emri dhe adresa e operatorëve ekonomikë të suksesshëm]

1. \_\_\_\_\_

2. \_\_\_\_\_

3. \_\_\_\_\_

\* \* \*

Procedura e prokurimit:

Përshkrimi i shkurtër i kontratës: [shuma, objekti, kohëzgjatja e kontratës, etj.]

Publikimet e mëparshme (nëse aplikohet): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në kosto

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim

Me anë të kësaj bëjmë me dije se, në këtë procedurë /lot kanë marrë pjesë operatorët ekonomikë të mëposhtëm me vlerat përkatëse si më poshtë:

1. \_\_\_\_\_

*Emri i plotë i shoqërisë*

\_\_\_\_\_

*Numri i NIPT-it*

Vlera e ofruar/ Totali i çmimeve për njësi dhe vlera e pritshme e kontratave (nëse është e zbatueshme) \_\_\_\_\_

\_\_\_\_\_

*(e shprehur në shifra dhe në fjalë)*

2. \_\_\_\_\_

*Emri i plotë i shoqërisë*

\_\_\_\_\_

*Numri i NIPT-it*

Vlera e ofruar/ Totali i çmimeve për njësi dhe vlera e pritshme e kontratave (nëse është e zbatueshme) \_\_\_\_\_

\_\_\_\_\_ *e shprehur në shifra dhe në fjalë)*

Etj. \_\_\_\_\_

Janë skualifikuar Operatorët ekonomikë e mëposhtëm:

1. \_\_\_\_\_

\_\_\_\_\_

*Emri i plotë i shoqërisë*

*arsyet*

\_\_\_\_\_

*Numri i NIPT-it*



---

2. \_\_\_\_\_

*Emri i plotë i shoqërisë*

*Numri i NIPT-it*

*arsyet*

\* \* \*

Duke iu referuar procedurës së mësipërme, ju informojmë se operatorët ekonomikë të mëposhtëm janë identifikuar si fitues (paraparak) të procedurës së prokurimit:

1. \_\_\_\_\_

*Emri i plotë i shoqërisë*

*Numri i NIPT-it*

Vlera / Totali i çmimeve për njësi dhe vlera e pritshme e kontratave (nëse është e zbatueshme ) \_\_\_\_\_

*(e shprehur në shifra dhe në fjalë)*

Totali i pikëve të marra \_\_\_\_\_

2. \_\_\_\_\_

*Emri i plotë i shoqërisë*

*Numri i NIPT-it*

Vlera e ofruar/ Totali i çmimeve për njësi dhe vlera e pritshme e kontratave (nëse është e zbatueshme ) \_\_\_\_\_

*(e shprehur në shifra dhe në fjalë)*

Totali i pikëve të marra \_\_\_\_\_

Etj. \_\_\_\_\_

Me publikimin e këtij njoftimi, fillojnë afatet e ankimit sipas përcaktimeve në nenin 110 të Ligjit Nr. 162/2020, datë 23.12.2020, "Për Prokurimin Publik".

---

## Shtojca 14

[Shtojcë për tu plotësuar nga Autoriteti Kontraktor në rastin e Marrëveshjes Kuadër]

### **FORMULARI I NJOFTIMIT TË OPERATORËVE EKONOMIKË TË SUKSESSHËM NË MARRËVESHJEN KUADËR (NË PËRFUNDIM TË AFATEVE TË ANKIMIT<sup>4</sup>)**

[Data]

Drejtuar: [Emri dhe adresa e operatorëve ekonomikë të suksesshëm]

1. \_\_\_\_\_
2. \_\_\_\_\_
3. \_\_\_\_\_

\* \* \*

Procedura e prokurimit:

Përshkrimi i shkurtër i kontratës: [shuma, objekti, kohëzgjatja e kontratës, etj.]

Publikimet e mëparshme (nëse aplikohet): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:

- oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në kosto
- oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim

Me anë të kësaj bëjmë me dije se në këtë procedurë /lot kanë marrë pjesë operatorët ekonomikë me vlerat përkatëse si më poshtë:

1. \_\_\_\_\_  
*Emri i plotë i shoqërisë* \_\_\_\_\_  
*Numri i NIPT-it*

Vlera/ Totali i çmimeve për njësi dhe vlera e pritshme e kontratave (nëse është e zbatueshme) \_\_\_\_\_

\_\_\_\_\_

(e shprehur në shifra dhe në fjalë)

2. \_\_\_\_\_  
*Emri i plotë i shoqërisë* \_\_\_\_\_  
*Numri i NIPT-it*

---

<sup>4</sup> Ky Formulari është i aplikueshëm nëse ka ankime

---

Vlera/ Totali i çmimeve për njësi dhe vlera e pritshme e kontratave (nëse është e zbatueshme) \_\_\_\_\_

(e shprehur në shifra dhe në fjalë)

Etj. \_\_\_\_\_

Janë skualifikuar Operatorët ekonomikë e mëposhtëm:

1. \_\_\_\_\_

Emri i plotë i shoqërisë  
arsyet

Numri i NIPT-it

2. \_\_\_\_\_

Emri i plotë i shoqërisë

Numri i NIPT-it

arsyet

\* \* \*

Duke iu referuar procedurës së mësipërme, ju informojmë se operatorët ekonomikë të mëposhtëm janë identifikuar si të suksesshëm:

1. \_\_\_\_\_

Emri i plotë i shoqërisë

Numri i NIPT-it

Vlera/ Totali i çmimeve për njësi dhe vlera e pritshme e kontratave (nëse është e zbatueshme) \_\_\_\_\_

(e shprehur në shifra dhe në fjalë)

Totali i pikëve të marra \_\_\_\_\_

2. \_\_\_\_\_

Emri i plotë i shoqërisë

Numri i NIPT-it

Vlera/ Totali i çmimeve për njësi dhe vlera e pritshme e kontratave (nëse është e zbatueshme) \_\_\_\_\_

(e shprehur në shifra dhe në fjalë)

Totali i pikëve të marra \_\_\_\_\_

Etj. \_\_\_\_\_

Si pasojë, nga ju kërkohet të paraqiteni tek [emri dhe adresa e Autoritetit Kontraktor] brenda \_\_\_\_\_ ditëve nga data e marrjes të këtij njoftimi për të lidhur marrëveshjen.

---

Ankesa pas Njoftimit te Fituesit (Paraparak)

PO  JO

Nëse Po (vendimi përfundimtar për trajtimin e ankesës/ave nr. datë) \_\_\_\_\_

Ankesa pas Njoftimit të Anullimit të procedurës:

PO  JO

Nëse Po (vendimi përfundimtar për trajtimin e ankesës/ave nr. datë) \_\_\_\_\_

**[TITULLARI I AUTORITETIT KONTRAKTOR]**

**Seksioni III Termet dhe Kushtet e Kontratës (TKK)**

Ky Seksion përmban :

Shtojca 15: Kushtet e Përgjithshme

Shtojca 16: Kushtet e Vecanta të Kontratës

Shtojca 17: Formulari i Sigurimit të Kontratës

---

## **Shtojca 15**

### **Kushtet e Përgjithshme të Kontratës (KPK)**

Këto Kushte të Përgjithshme të Kontratës (KPK), së bashku me Kushtet e Veçanta dhe dokumentet e tjera të renditura në to, përbëjnë një dokument të plotë që shpreh të drejtat dhe detyrimet e palëve.

#### **Neni 1 Dispozitat e përgjithshme**

##### **1.1 Përkufizimet**

Në Kushtet e Kontratës ("këto Kushte"), të cilat përfshijnë Kushtet e Veçanta dhe këto Kushte të Përgjithshme, fjalët dhe shprehjet e mëposhtme kanë këto kuptime:

##### **1.1.1 Kontrata**

**1.1.1.1** "Kontrata" do të thotë kontrata me shpërblim, e lidhur me shkrim, ndërmjet një apo më shumë operatorëve ekonomikë dhe një ose më shumë autoriteteve kontraktore, që kanë si objekt kryerjen e punimeve, furnizimin e mallrave dhe shërbimeve, në përputhje me LPP.

**1.1.1.2** "Dokumentet e Kontratës" do të thotë dokumentet e renditura në Kontratë, përfshirë çdo ndryshim të saj.

**1.1.1.3** "Çmimi i Kontratës" do të thotë çmimi që i paguhet Furnizuesit siç specifikohet në kontratë.

- 
- 1.1.1.4** "Përfundimi" do të thotë përmbushja e të gjitha detyrimeve, me ose pa penalitet, nga Furnizuesi në përputhje me termat dhe kushtet e përcaktuara në Kontratë.
- 1.1.1.5** "Ndërprerje e Kontratës" do të thotë mosvijimi i ekzekutimit të Kontratës sipas përcaktimeve në Nenin 23.
- 1.1.1.6** "Specifikime teknike" do të thotë karakteristikat e Shërbimeve objekt kontrate dhe çdo shtesë dhe modifikim i këtyre karakteristikave në përputhje me Kontratën.
- 1.1.1.7** "Termet e Referencës" shprehin objektin dhe qëllimin e kontratës, përcaktojnë detyrat, kërkesat, objektivat, shpërndarjen, vendin dhe dorëzimin e Shërbimeve që do të sigurohen.
- 1.1.1.8** "Listat" do të thotë dokumenti (et) me titull Listat të plotësuara nga Furnizuesi dhe të dorëzuara me ofertën, siç janë të përfshira në Kontratë . Dokumente të tilla mund të përfshijnë Listat e Çmimeve të dhëna, Listat e tarifave dhe / ose çmimeve.
- 1.1.1.9** "Ofertë" do të thotë oferta ekonomike dhe të gjitha dokumentet e tjera që Furnizuesi ka dorëzuar me ofertën ekonomike, siç janë përfshirë në Kontratë.
- 1.1.1.10** "KPK" do të thotë Kushtet e Përgjithshme të Kontratës.
- 1.1.1.11** "KVK" do të thotë Kushtet e Veçanta të Kontratës.
- 1.1.2 Palët e Kontratës**
- 1.1.2.1** "Palë" do të thotë nënshkruesit e kontratës, në cilësinë e Blerësit dhe Furnizuesit sipas kontekstit.
- 1.1.2.2** "Blerës" do të thotë Autoriteti Kontraktor përfituesi i Shërbimeve objekt kontrate.
- 1.1.2.3** "Furnizues" do të thotë operatori (ët) ekonomik që kryen furnizimin Shërbimeve objekt kontrate.
- 1.1.2.4** "Nënkontraktor" do të thotë çdo subjekt i caktuar si nënkontraktor për kryerjen e një pjese të Shërbimeve.
- 1.1.3 Llogaritja e afateve**
- 1.1.3.1** "Ditë" do të thotë një ditë kalendarike.
- 1.1.4 Shërbimet**
- 1.1.4.1** "Shërbime" do të thotë të gjitha detyrat që do të kryhen nga Furnizuesi sipas Kontratës.
- 1.1.5 Përkufizime të tjera**

- 
- 1.1.5.1** "Adresa e Blerësit" është adresa e specifikuar në KVK.
- 1.1.5.2** "Forca Madhore" është përcaktuar në Nenin 20 "Forca Madhore".
- 1.1.5.3** "Sigurimi i Kontratës" është sipas përcaktimeve të Nenit 11 "Sigurimi i Kontratës".
- 1.1.5.4** "Vendi i kryerjes së Shërbimeve", do të thotë vendi i përcaktuar në KVK.
- 1.1.5.5** "E paparashikueshme" ose "E paparashikuar" do të thotë një ngjarje objektivist e pamundur të parashikohet në momentin e publikimit të Njoftimit të Kontratës në SPE.
- 1.1.5.6** Modifikimi i kontratës" është sipas përcaktimeve në Nenin 21.
- 1.1.5.7** "Legjislacioni në fushën e prokurimit" do të thotë LPP-ja, Rregullat e Prokurimit Publik dhe akte të tjera nënligjore në bazë dhe për zbatim të LPP –së siç specifikohet në KVK.
- 1.1.5.8** "Praktikat e Ndaluar" kanë kuptimin e përcaktuar në LPP.

## **1.2 Interpretimi**

### **1.2.1** Interpretimi i Kontratës, përveç kur konteksti kërkon ndryshe:

- (a) fjalët që tregojnë një gjini përfshijnë të gjitha gjinitë;
- (b) fjalët që tregojnë njëjësin përfshijnë edhe shumësin dhe fjalët që tregojnë shumësin përfshijnë edhe njëjësin;
- (c) dispozitat që përfshijnë fjalën "bie dakord", "rënë dakord" ose "marrëveshje" kërkojnë që marrëveshja të dokumentohet me shkrim;
- (d) "i shkruar" ose "me shkrim" do të thotë i shkruar me dorë, i shkruar me makinë, printuar ose i bërë në mënyrë elektronike.

### **1.2.2** Modifikimi

Çdo modifikim i Kontratës i cili nuk kryhet me shkrim, dhe nuk përmban datën, apo nuk i referohet shprehimisht Kontratës dhe nuk nënshkruhet nga një përfaqësues i autorizuar rregullisht i secilës Palë është i pavlefshëm. Palët nuk mund të bëjnë modifikime të asnjë elementi të kontratës që do të sillnin ndryshime thelbësore në kushtet mbi bazën e të cilave është përzgjedhur Furnizuesi.

### **1.2.3** Heqja dorë

Çdo heqje dorë nga të drejtat, kompetencat ose mjetet ligjore të një Pale sipas Kontratës duhet të bëhet me shkrim, me datë dhe e nënshkruar nga një përfaqësues i autorizuar i Palës që bën këtë dorëheqje, dhe duhet të specifikojë të drejtën dhe masën nga e cila po hiqet dorë.

